

1 E enjte, 21 prill 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi.

7 Znj. Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Së pari, të marrim mungesat.

14 Znj. Prokurore, e keni fjalën ju.

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve. Zyra
16 e Prokurorit të Specializuar përfaqësohet sot nga Filippo De
17 Minicis, Prokuror i Asociuar; Julie Mann, menaxhere e
18 çështjes; stazhierja ligjore Marie-Cecile Grudzinski; dhe unë
19 që jam gjithashtu përfaqësuese e ZPS-së.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Avokatja e Viktimave.

22 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve. Unë
23 jam përfaqësuesja e viktimave.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

25 Avokat i Mbrojtjes.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjesi të gjithëve. I
2 pranishëm në seancë sot jam unë, Julius von Bone; hetues dhe
3 përkthyes Fatmir Pelaj dhe gjithashtu edhe bashkëavokati. Edhe
4 i akuzuari po ashtu, për procesverbal, është i pranishëm këtu.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Sa për procesverbal më lejoni të them që po shfaqeni para
8 Trupit Gjykues 1.

9 Do të vazhdojmë sot me dëshminë e Dëshmitarit Musli
10 Halimi.

11 Znj. Sekretare, ju lutem ta shoqëroni dëshmitarin në
12 sallë.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Halimi, mirëmëngjesi.

16 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
18 mirë se erdhët në Dhomat e Specializuara të Kosovës. Më
19 dëgjoni mirë?

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
22 mirë. Si jeni, patët kohë që të pushonit?

23 DËSHMITARI: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
25 mirë. Z. Halimi, dua t'ju kujtoj që jeni akoma nën betim për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 3

1 të treguar të vërtetën. A e kuptoni këtë?

2 DËSHMITARI: Po.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 rregull. Tani do t'ia jap fjalën znj. Prokurore, në mënyrë që
5 ajo të vazhdojë me pjesën e fundit të pyetjeve të saj.

6 Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
8 Gjykatës. Besoj që do më duhen rreth 15 minuta.

9 DËSHMITARI: MUSLIM HALILI [Vijon]

10 Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli

11 [Vazhdim]

12 Py. Mirëmëngjesi Z. Halimi.

13 Pë. Mirëmëngjesi.

14 Py. Kam ende disa pyetje për ju sot për t'jua bërë.

15 Së pari, dua të diskutojmë për Rrahman Dinin. Ju na dhatë
16 disa të dhëna lidhur me Rrahman Dinin dje. Thatë që z. Dini
17 ishte personi që ju tha që Cali ishte komandanti i BIA-s. Për
18 procesverbal kjo është përmendur në faqen përkatëse të
19 procesverbalit dje. Dhe thatë që ishte Rrahman Dini, me sa
20 mbani mend juve, që ka qenë Shefi i Shtabit i Brigadës 153.
21 Edhe kjo domethënë është në procesverbalin e djeshëm.

22 Kam disa pyetje për ju lidhur me Rrahman Dinin. Sa herë
23 jeni takuar apo sa herë keni pasur punë me z. Rrahman Dinin,
24 në mars dhe në prill të 1999?

25 Pë. Me Rrahman Dinin kam pas shumë kujtime gjatë luftës. Një

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 4

1 ndër to ka qenë i bashkuar me të plagosur kur unë...

2 Py. Le të përqendrohemi tek marsi dhe prilli i vitit 1999, ju
3 lutem. Në rregull?

4 Pë. Po. Po flas për datën 18 prill.

5 Py. Në rregull. Me lejoni t'jua bëj pyetjet e mia. Pyetja ime
6 e parë ishte kjo, a keni pasur punë a keni pasur takime me të
7 në periudhën nga marsi deri në prill të 1999? A e kuptoj saktë
8 që përgjigja është, po?

9 Pë. Takim, jo. Por unë e kam mbart në shpinë Rrahman Dinin
10 diku 5 kilometra. Sepse ai ka qenë i sëmurë bashkërisht me të
11 plagosurit. Unë i kam tërheq prej Prapashtice deri në Koliq.
12 Edhe aty e kam njohur Rrahman Dinin edhe...

13 Py. Në rregull. Ju thatë që ai ishte i sëmurë. Çfarë mund të
14 na thoni për gjendjen shëndetësore të z. Dini? Sërish po flas
15 për periudhën mars-prill 1999.

16 Pë. Saktësisht ça ka qenë i sëmurë, unë nuk e di. Por ai s'ka
17 mund të lëvizë. Me sa unë e di, i saktë nuk jam, ka qenë i
18 sëmurë prej zemrës, prej mushkërisë. Por, mundësia e tij me
19 ec, nuk ka qenë. Domethënë ka qenë fizikisht i -- nuk ka mund
20 të ecë. Edhe unë kam qenë ai që është dash t'i barte të
21 plagosurit me ushtarët e mi të batalionit tim të Prapashticës,
22 nga Prapashtica deri në Koliq. Dikun, vija ajrore është 5
23 kilometra. Dhe këtu më ka ra me Rrahman Dinin që kam mbet i
24 rrethuar në një vend edhe 2 ditë të tjera. Domethënë, s'kam
25 pas mundësi të depërtoj prej forcave serbe.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 5

1 Aty më ka ra me ndej mua 2 ditë e dy net me Rrahman
2 Dinin. Aty unë e kam mbart prej Keçekollë deri në Koliq. Aty
3 kemi pas mundësi të bisedojmë.
4 Py. Në rregull. Kur ka ndodhur kjo? Kam përshtypjen se thatë
5 në gjysmën e dytë të prillit 1999?
6 Pë. Saktësisht data nuk më kujtohet, por unë e mendoj se ka
7 qenë diku 18-19 prill, kur ka qenë ofensiva e Zllashit.
8 Py. Në rregull. Ju thatë që e keni mbajt nga Keçekolla në
9 Koliq? Ku ekzaktësisht e çuat ju atë në Koliq? Ku e latë?
10 Pë. Në Koliq ka qenë një batalion tjetër i Brigadës 153.
11 Detyra jonë ka qenë ta çojmë deri në atë bazë. Edhe të
12 kthehemi prapë në Prapashticë.
13 Py. A e kuptova drejtë nga dëshmia që dhatë dje se Z. Dini,
14 në periudhën nga marsi deri në prill 1999 edhe flas për
15 periudhën kur ju keni qenë në Zllash, a e kam kuptuar drejtë
16 se ai ka qëndruar në shtabin e Brigadës? E kam fjalën për
17 Brigadën 153. Është kështu?
18 Pë. Unë mendoj që, po. Ai ashtë dasht të qëndrojë në brigadë.
19 Py. Në rregull. Z. Halimi, dëshiroj t'ju tregoj dy fotografi.
20 Janë fotografi të cilat janë të ngjashme me fotografitë që i
21 diskutove dje me Avokatin e Mbrojtjes. Por janë me ngjyra, në
22 mënyrë që të mund të shquhen më mirë.
23 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem, a mund të shfaqen në
24 ekran dokumentet SPOE00287801 dhe fotografia tjetër me numër
25 identifikimi SPOE00287803.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

2 lutem shfaqini, znj. Sekretare.

3 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]:

4 Py. Z. Halimi, a i shihni dy fotografitë në ekran?

5 Pë. Po.

6 Py. A e njihni këtë godinë? Çfarë është kjo godinë?

7 Pë. Kjo është ish-shkolla e Zllashit.

8 Py. Ju patë një fotografi të ngjashme që ishte identifikuar
9 si DSM00549, që ishte bardhë e zi.

10 Ndërkohë që kjo është një fotografi me ngjyra. Dhe juve e
11 pranoni që është e njëjta ndërtesë. Është e saktë kjo?

12 Pë. Me sa duket, po.

13 Py. Dhe nga "ish-shkolla e Zllashit", e keni fjalën për
14 shkollën ku është organizuar trajnimi në qendrën stërvitore.

15 Për këtë e keni fjalën, apo jo?

16 Pë. Po.

17 Py. Në rregull.

18 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Mund t'i heqim fotografitë nga
19 ekrani.

20 Py. Z. Halimi, dje Avokati i Mbrojtjes ju bëri disa pyetje
21 lidhur me BIA-n. Kjo është reflektuar në faqen e transkriptit
22 të ditës së djeshme 174 [sipas përkthimit] dhe ju thatë që
23 keni dëgjuar për BIA-n, por nuk është se keni pasur kontakte
24 të vazhdueshme me të. A e mbani mend ta keni thënë këtë gjë ?

25 Pë. Po.

1 Py. Unë ju pyeta gjatë kundërpjetjeve të Prokurorisë, në
2 qoftë se e dinit nëse BIA kishte bazë në Zllash. Dhe përgjigja
3 juaj ishte që nuk e dinit këtë gjë. Kjo reflektohet në faqen
4 3816 të transkriptit zyrtar të ditës së djeshme.

5 Z. Halimi, ne kemi prova që na tregon që një prej vendeve
6 ku ishte vendosur BIA, ishte në Zllash, që ka qenë më sipër
7 shkollës. A jeni në dijeni të kësaj gjëje?

8 Pë. Jo.

9 Py. Pra, po thoni që nuk keni dëgjuar asnjëherë për këtë gjë,
10 ndërkohë që keni qenë në Zllash gjatë atyre muajve? Këtë po
11 thoni?

12 Pë. Po.

13 Py. A keni shkuar ndonjëherë në kodër, i jeni ngjitur
14 ndonjëherë kodrës nga shkolla?

15 Pë. Jo. Poligoni ku unë jam marrë me stërvitje, e kam pas
16 mbrapa shkolle. Jo nga hyrja e shkollës, por mbrapa shkolle.
17 Edhe të gjithë aktivitetin e kena ba në atë poligon. Ai ka
18 qenë diku 400-500 metra larg shkolle. Kështu që, ka qenë shumë
19 intensiv trajnimi edhe nuk kam pas mundësi unë të dal të
20 shëtis, të shikoj kodra apo objekte. Unë jam marrë me
21 detyrën...

22 Py. Në rregull. Përveç shkuarjes atje në atë vend ose në
23 vende të tjera, a jeni takuar ndonjëherë ose a keni pas të
24 bënit me anëtarët e BIA-s ndërkohë që keni qenë në qendrën
25 stërvitore ose në afërsi të qendrës stërvitore, në periudhën

1 nga marsi deri në prill të vitit 1999?

2 Pë. Jo vetëm BIA, por me asnjë person apo ushtar përpos
3 kadetëve, nuk kam pas kontakte në qendrën stërvitore.

4 Py. Përgjigjen nuk e kam të qartë. Përgjigjen që dhatë nuk e
5 kam të qartë. A po thoni që jeni takuar me ushtarët e BIA-s
6 dhe me ushtarë të tjerë?

7 Pë. Jo, e kuptove gabimisht. Unë thashë, as me BIA-n, por as
8 me ndonjë ushtar tjetër përpos kadetëve nuk kam pas kontakte
9 në qendrën stërvitore. Domethënë, vetëm kadetët e
10 instruktorët. Qasje në qendrën stërvitore s'ka pas dikush
11 tjetër. Kjo ka qenë edhe e ndaluar, nuk ka mund kushdo të vijë
12 aty të manipulojë apo të bashkëpunojë me kadetët. Kjo ka qenë
13 strikt e ndaluar. Trajnimi është kryer me kadetët.
14 Instruktorët janë marrë me kadetët. Edhe kjo ka qenë e tëra.
15 Edhe me pas dash, s'i është lejuar. S'ka pas të drejtë dikush
16 të vij në qendrën stërvitore.

17 Py. Në rregull. E kuptoj. Ju keni ndenjur thua jse 3 muaj në
18 Zllash. Dhe po thoni, që gjatë kësaj periudhe kur keni qenë në
19 Zllash, ju nuk keni pasur fare kontakt me ushtarë të tjerë
20 qofshin ata të BIA-s ose të njësive të tjera, përveç rekrutëve
21 dhe instruktorëve që punonin në qendrën e trajnimit. Këtë po
22 thoni?

23 Pë. Po.

24 Py. Në rregull. Përveç Salih Mustafës, a njihnit ju ndonjë
25 anëtar tjetër të BIA-s, pavarësisht nga fakti në qoftë se keni

1 pasur kontakte me ta apo jo?

2 Pë. Jo.

3 Py. A e dini në qoftë se keni trajnuar ndonjë anëtar të BIA-s
4 ndërmjet rekrutëve të ndryshëm, të gjeneratave të ndryshme që
5 keni trajnuar?

6 Pë. Nuk e besoj, jo.

7 Py. Nuk jeni i sigurt, nuk e besoni apo jo definitive?

8 Pë. Nëse më lejon ta shpjegoj. Kadetët që kanë ardhur në
9 qendrën stërvitore, unë nuk jam marrë me biografinë e tyre apo
10 ardhjen e tyre. Kjo është përgatitë, është para përgatitë dhe
11 lista ka ardhur e saktë. Kështu që unë, nuk ka qenë detyrë e
12 imja të merrem me të dhënat apo me biografinë e çdonjërit kush
13 është, çka është. Detyra ime ka qenë me i trajnue. Edhe me iu
14 përmbajt listës që ka ardh nga komanda e Brigadës 153. Kjo
15 është.

16 Py. Në rregull. Pra, ju po thoni që nuk e dini në qoftë se në
17 fakt ka pasur anëtarë të BIA-s ndërmjet rekrutëve të trajnuar,
18 sepse ju nuk i dinit rekrutet njëri pas tjetrit? Domethënë,
19 nuk është se i njihnit emrat, mbiemrat e tyre, nga vinin dhe
20 ku do të shkonin ato pastaj mbas trajnimit?

21 Kështu është?

22 Pë. Po.

23 Py. Në rregull. Z. Halimi, ju i keni dhënë një deklaratë
24 Mbrojtjes së z. Mustafa më 17 gusht 2021. A mund të na thoni
25 se kush ju lidhi me ekipin e Mbrojtjes, në mënyrë që të mund

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 10

1 të jepni këtë deklaratë? Kush ju vuri në kontakt me të?

2 Pë. Mua më kanë thirr në telefon avokatët e Salih Mustafës.

3 Kështu që, person kryesor nuk mund të them që dikush më ka

4 ardhur më ka thënë. Por, jam takuar me avokatët e Salih

5 Mustafës. Nuk më kanë bërë presion. Me vetëdëshirë jam takuar

6 me ta. Kush iu ka thënë atyre, unë nuk e di. Por, ata më kanë

7 thirr mua dhe me vetëdëshirë unë e kam pranuar dhe kam dhënë

8 deklaratë.

9 Domethënë, s'kam pas ndonjë censurë, shtyrje por me
10 vullnet e kam.

11 Py. E kuptoj. Pasi dhatë deklaratën, a keni folur për faktin

12 që keni dhënë deklaratë? E keni folur këtë gjë me ndonjë

13 person në rrethin tuaj të kontakteve, me njerëzit që i njihni?

14 Pë. Jo.

15 Py. Po familja juaj, e ishte në dijeni të kësaj gjëje? Të

16 faktit që keni dhënë një deklaratë?

17 Pë. Jo.

18 Py. Pra, nuk e keni diskutuar as me familjen dhe nuk e keni

19 diskutuar me askënd tjetër fare këtë gjë? Këtë thatë?

20 Pë. Jo. S'ka qenë një gjë që është dash ta diskutoj. Kjo nuk

21 ka qenë diçka inte-- . Jo, nuk e kam diskutuar.

22 Py. Në rregull. Si e mësuar arrestimin, si e morët vesh që u

23 arrestua Salih Mustafa?

24 Pë. Përmes mjeteve të informimit.

25 Py. Do të thuash nga televizioni, nga lajmet, Facebook-u?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 11

1 Çfarë do të thuash konkretisht?

2 Pë. Lajmet, po. Nga televizioni.

3 Py. Në rregull. A ke pasur mundësi që të njihesh me akuzat në
4 kuadër të kësaj çështje? Pra, në çështjen kundra Salih
5 Mustafës?

6 Pë. Jo.

7 Py. Pra, nuk e keni lexuar lëndën se cilat janë akuzat e
8 ngritura nga Zyra e Prokurorit? Këtë po thua?

9 Pë. S'e kam lexuar.

10 Py. Në rregull. Pas arrestimit të z. Mustafa, a keni qenë në
11 kontakt me ndonjë nga anëtarët e familjes së z. Mustafa?

12 Pë. Jo. Po unë s'ia njoh familjen Salih Mustafës.

13 Py. Gjithashtu dje na thatë se jeni takuar me z. Brahim
14 Mehmetaj, i njohur ndryshe si Bimi, pas luftës dhe keni punuar
15 bashkë në komunë. Kjo jepet në transkript në faqen 3765.

16 A keni folur me z. Mehmetaj pas arrestimit të z. Mustafa
17 në ndonjë kohë?

18 Pë. Jo. Me Brahim Mehmetaj kam punuar në vitin 2018, 2019,
19 2020. Ai ka qenë në një drejtori tjetër, unë kam qenë në një
20 drejtori tjetër. E vetmja është që kemi punuar në një komunë,
21 në një institucion.

22 Py. Në rregull. Pra, thatë që nuk keni folur me të kohët e
23 fundit, pas arrestimit të z. Mustafa. Është e saktë kjo? Këtë
24 thatë?

25 Pë. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 12

1 Py. A e dini se z. Mehmetaj ka dhënë dëshmi përpara kësaj
2 gjykate në këtë çështje?

3 Pë. Jo.

4 Py. A keni ndjekur ndonjë nga proceset gjyqësore të kësaj
5 çështje, kur seancat gjyqësore janë transmetuar në media, në
6 televizion ose që kanë qenë të hapura për publikun?

7 Pë. Me thënë të drejtën, jo. Nuk e kam përcjellë dhe aq
8 shumë. Jo.

9 Py. Kur thua "jo aq shumë", do të thuash që disa i ke ndjekur
10 dhe nuk i ke ndjekur të gjitha? Çfarë do të thuash?

11 Pë. Nuk mund të them se s'i kam dëgjuar fare, por jo dhe
12 shumë. S'jam marrë me këtë punë, s'i kam përcjellë.

13 Py. A do të thuash se --. Çfarë do të thuash saktësisht, që
14 keni dëgjuar apo keni përcjellë disa prej seancave, keni
15 lexuar informacion që është botuar në media? A mund të na e
16 sqarosh se deri në çfarë mase ju keni përcjellë një pjesë të
17 proceseve gjyqësore?

18 Pë. Unë e ceka që, nuk mund të them që kam qenë shumë i
19 interesuar t'i përcjell. Unë nuk e kam përcjellë. Aty-këtu,
20 ndonjëherë ndonjë lajm e kam dëgjuar. Se Radio Televizioni i
21 Kosovës jep çdo herë këto seanca dhe ka mund ta dëgjoj
22 ndonjëherë përmes televizionit.

23 Py. Po thoni që e mbani mend që keni dëgjuar disa prej
24 proceseve gjyqësore?

25 Pë. Nuk mund ta mbaj çka kam dëgju. Por nuk mund të them që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Musli Halimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. D'Ascoli (Vazhdim)

Faqe 13

1 s'kam dëgju.

2 Py. Në rregull. E qartë. A e mbani mend se cilët pjesë ka
3 ndodhur që të përcillni ose që të dëgjoni?

4 Pë. Jo, jo.

5 Py. A e mbani mend se cilët dëshmitarë po jepnin dëshmi në
6 ato ditë që ka ndodhur të keni përcjellë disa prej proceseve
7 gjyqësore?

8 Pë. Nuk i kam përcjellë, nuk e di.

9 Py. Nuk e mbani mend fare? Nuk mbani mend asnjë hollësi?

10 Pë. Jo.

11 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
12 konsultohem shkurtimisht me kolegët dhe mendoj që nuk do të
13 kem shumë pyetje.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
15 lutem, vazhdoni.

16 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

17 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim]

18 Py. Z. Halimi, shumë faleminderit. Këto ishin pyetjet e mia.

19 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam
20 pyetje të tjera për dëshmitarin.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit znj. Prokurore.

23 Avokatja e Viktimave, e keni ju tani fjalën për pyetjen
24 tuaj.

25 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

1 Gjykatës.

2 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave: [Përkthim]

3 Py. Përshëndetje Z. Halimi.

4 Pë. Përshëndetje.

5 Py. Unë jam Brechtje Vossenberq, që jam bashkëavokate për
6 Viktimat. Kam disa pyetje të shkurtra të cilat kanë të bëjnë
7 me ato çfarë thatë dje.

8 Pyetja e parë ka të bëjë me mënyrën se si flinin
9 rekrutët. Në dëshminë që na dhatë dje na thatë diçka lidhur me
10 këtë. I referohem këtu faqes 3749 të transkriptit zyrtar, ku
11 ju konfirmuat që kishte një hapësirë me shtretër për fjetje në
12 shkollë.

13 Unë dua t'ju pyes se çfarë lloj shtretërish përdorëshin
14 nga rekrutët, çfarë shtretër kishte në shkollë, lloji i
15 shtratit që përdorej.

16 Pë. Po. Ata nuk e kanë pas një fjetje luksoze, të standardit.
17 Por, ata e kanë kuptuar që janë në gjendje lufte. Krevatet
18 kanë qenë prej druri, por dy kate domethënë, një dhe dy. Aty
19 kanë nxënë vend ma shumë, kanë mund me fjet ushtarë ma shumë.
20 Por ka ndodhë dhe që kanë fjet dy vetë në një krevat. Ose dhe
21 në mes krevateve ka pas dyshekë e kanë fjet. Sepse hapësira ka
22 qenë e vogël, nuk ka qenë me i plotësu kushtet ashtu qysh
23 lypen.

24 Py. Po, e kuptoj. Në krevat dy katesh edhe dyshekë, që thoni.
25 E kuptoj. Në rregull. Faleminderit. Këtë pyetje kisha lidhur

1 me këtë temë.

2 Për një temë tjetër. Dje na thatë gjithashtu që jeni

3 trajnuar në arte marziale. I referohem faqes 3792 të

4 transkriptit. Në çfarë artesh marziale jeni trajnuar?

5 Pë. Unë përpos fakultetit të edukatës fizike, jam marrë edhe

6 me sportin karate. Ku posedoj edhe e kam shkallën e dytë. Edhe

7 kjo më ka shty që të merrem edhe me këtë punë, të trajnoj

8 ushtarë t'i para përgatis për luftë. Me ato mundësitë e mia që

9 kam pas. Kjo është ajo.

10 Py. Në rregull. A keni marrë një nivel të caktuar të

11 karatesë? E kam fjalën këtu për rripin e karatesë, keni ndonjë

12 nivel të caktuar aftësie?

13 Pë. Ta thashë, e kam shkallën e dytë. Ose 2 Dan, s'di qysh e

14 kupton. Është brezi i zi? Po shkon me shkallë, shkalla 1 dhe

15 2. E kupton?

16 Py. Pra shkalla dy, brezi i zi? Kjo?

17 Pë. Ja, ja [fonetike].

18 Py. Faleminderit për këtë. Pra, jeni marrë me trajnimin

19 fizik, por ndërkohë dje dëshmuat gjithashtu që një pjesë e

20 trajnimit të rekrutëve ishte trajnim për përdorimin e armëve.

21 Pyetja për ju është kjo, për çfarë lloj armësh trajnoheshin

22 rekrutët që të përdornin?

23 Pë. Pjesën e armatimit nuk e kam pas unë. E kanë pas kolegë

24 të tjerë. Por, rekrutët janë trajnuar për përdorimin e armës

25 automatik edhe arma e brezit, ne e quajmë TT.

1 Py. Në rregull. A bënin stërvitje shtirje, qitje. Dhe për
2 shembull ju thatë dje që rekrutët do të duhej që të bënin
3 testin që të bënin qitje. Përmendët gjithashtu edhe gamën e
4 qitjeve, në faqen 3791. Gjithashtu e përmendët qitjen edhe
5 sot.

6 Pë. Po. Ata është dash ta kuptojnë montimin, çmontimin,
7 përdorimin e armës. Por, është dash të testohen në fund
8 shenjëzimin, qitjen. Këtë nuk e kena ba me ato armë. Kena pas
9 armë ajrore, i quajmë. Se s'kemi pas municion ne të harxhojmë
10 për gjuajtje. Municionin është dash ta ruajmë për diçka
11 tjetër. Kështu që testimin e kanë kryer me armë, i quajmë armë
12 ajrore. Jo municion -- municion shkollor.

13 Py. Në rregull.

14 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia, të
15 nderur Gjykatës. Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit, Mbrojtësja e Viktimave.

18 Kthehem tani nga Avokati i Mbrojtjes, i cili mund të bëj
19 pyetjet e tij plotësuese. Keni fjalën.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Shumë
21 shkurt.

22 Pyetje vijuese z. Von Bone: [Përkthim]

23 Py. Z. Dëshmitar, e kam edhe një pyetje.

24 Më herët, pyetjes së Prokurores iu përgjigjet dhe është
25 në faqen 8, rreshti 7, 8 dhe 9. Bëhej fjalë për pyetjen e

1 Prokurorisë:

2 "E kisha për detyrë vetëm t'i stërvitja edhe me listën që
3 merrja nga komanda e Brigadës 153".

4 Pyetja që kam është kjo: A keni marrë ndonjë listë nga
5 ndonjë brigadë tjetër veç Brigadës 153?

6 Pë. Jo.

7 Py. A keni marrë ndonjëherë ndonjë listë nga BIA?

8 Pë. Jo.

9 Py. Në rregull. Këto ishin pyetjet.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë.

11 DËSHMITARI: Faleminderit shumë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit, z. Avokat i Mbrojtjes.

14 Pyes ZPS-në. Nuk e di nëse keni pyetje plotësuese?

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse. Asgjë
16 më shumë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Mbrojtësja e Viktimave?

20 ZNJ. VOSENBERG: [Përkthim] Jo, faleminderit e nderuar
21 Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë

23 mirë. Atëherë, Z. Halimi, ju kanë bërë pyetje palët dhe

24 Mbrojtësja e Viktimave. Tani e ka rendin Trupin Gjykses që

25 t'ju bëj disa pyetje. Këto pyetje do të na japin mundësi që të

1 qartësohemi më shumë në lidhje me dëshminë që ju keni dhënë
2 sot.

3 Shoh kolegët nëse kanë pyetje. Nuk ka pyetje asnjë prej
4 kolegëve? As unë nuk kam pyetje në fakt. Kështu që Trupi
5 Gjykues nuk ka pyetje për ju Z. Halimi. Çka do të thotë se
6 kemi ardhur kështu në fund të dëshmisë suaj.

7 Dëshiroj që t'ju falënderoj shumë për kohën, për dëshminë
8 që dhatë dje dhe sot. E cila do të na ndihmojë të jemi më të
9 qartë se çfarë ka ndodhur asokohe. Dhe për të vijuar me
10 përpjekjet tona për të gjetur të vërtetën.

11 Ju falënderoj shumë. Ju uroj udhëtim të mbarë, kthim të
12 mbarë në shtëpi. Ju rikujtoj të mos ta diskutoni dëshminë që
13 keni dhënë para Dhomave të Specializuara me askënd.

14 DËSHMITARI: OK. Faleminderit

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
16 Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të dalë
17 nga salla.

18 [Dëshmitari largohet]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

21 Është ora 10.05.

22 Z. Avokat i Mbrojtjes, e keni ju në dorë. Ose mund të
23 bëjmë pushim tani 30 minuta dhe pastaj të vijojmë me dëshminë
24 e dëshmitarit tjetër ose nëse jeni gati mund të vazhdojmë
25 menjëherë.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, preferojmë
2 të bëjmë një pushim të shkurtër. Jo medoemos 30 minuta edhe 20
3 minuta. Gjithsesi e kemi të nevojshëm këtë pushim.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
5 Prokurore?

6 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse.

7 Përpara se të bëjmë ndërprerjen e seancës për këtë
8 pushim, kemi një kërkesë të përbashkët me palët dhe Mbrojtësen
9 e Viktimave, e ngjashme me muajin që shkoi, sa i takon
10 parashtrimeve që palët duhet që të dorëzojnë deri në fund të
11 muajit në përputhje me Vendimin 170 të Trupit Gjykses për
12 zhvillimin e procesit. Do të vlerësonim që edhe këtë muaj të
13 kishim një shtyrje të shkurtër të afatit duke pasur parasysh
14 dhe numrin e dëshmitarëve që janë paraqitur deri tani dhe
15 faktin që disa prej nesh javën e ardhshme do të kenë mundësinë
16 që të bëjnë disa ditë pushim. E diskutuam këtë edhe me
17 Avokatin e Mbrojtjes, nuk e di nëse mund të dorëzonim
18 parashtrimet për pranimin e provave të përdorura me
19 dëshmitarët që janë dëgjuar gjatë muajit prill, brenda datës 9
20 maj, që është ditë e hënë. Kjo do të na ndihmonte, e nderuar
21 Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
23 Faleminderit znj. Prokurore. Do t'ju informoj për këtë dhe do
24 të lëshoj urdhrin gojarisht.

25 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
2 rregull. Do të rifillojmë pas 20 minutash. Pak a shumë i bie
3 ora 10.30. Një pushim me i shkurtër.

4 Këtu ndërpritet seanca.

5 --- Pauza fillon në orën 10.08

6 --- Seanca rifillon në orën 10.30

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
8 se jeni rikthyer. Shoh se ekipet kanë të njëjtën përbërje. Çdo
9 të vijojmë tani me dëshminë e dëshmitarit 1400, z. Selatin
10 Krasniqi.

11 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin
12 të hyjë në sallë.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
15 Krasniqi, mirëmengjes, mirë se keni ardhur në Dhomat e
16 Specializuara.

17 DËSHMITARI: Mirëmengjes, mirë se ju gjeta.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
19 dëgjoni mirë?

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
22 mirë.

23 Pikë së pari, si jeni?

24 DËSHMITARI: Mirë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

1 Z. Krasniqi, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Ju kanë
2 thirrur të dëshmoni para Dhomave të Specializuara në çështjen
3 gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës për
4 ta ndihmuar Trupin Gjykses për të marrë një vendim.

5 Pasi të bëni deklaratën solemne për të thënë të vërteten,
6 do t'ju bëjë pyetje Avokati Mbrojtës i z. Mustafa, që është
7 ulur në të djathtën tuaj. Përfaqësuesit e Prokurorisë që i
8 keni në të majtë dhe pas kësaj Përfaqësuesit e Viktimave dhe
9 në fund anëtarët e Trupit Gjykses mund të kenë pyetje për ju.

10 Në rregull? I kuptuat këto të gjitha?

11 DËSHMITARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKSES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
13 mirë. Dëshiroj t'ju jap disa udhëzime se si t'i përgjigjeni
14 pyetjeve që do tua bëjmë. Z. Krasniqi ju lutem dëgjojeni me
15 kujdes secilën pyetje. Nëse nuk e kuptoni lirisht mund të
16 kërkoni që pyetja t'ju përsëritet. Dëshirojmë të na thoni të
17 vërteten. Të tregoni çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar apo
18 ndjerë ju vetë. Nëse i keni marrë vesh në një mënyrë tjetër,
19 duhet ta thoni këtë, të shpjegoni se si e keni marrë vesh.
20 Mund të mos ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjes. S'ka
21 problem për këtë. Ju lutem dëshmoni vetëm për aq sa mbani
22 mend. Mund të thoni "Nuk e di", "Nuk më kujtohet" dhe s'ka
23 problem nëse thoni kështu.

24 Përgjigjuni vetëm pyetjeve. Nëse ka nevojë për sqarime do
25 t'ju kërkohet sqarimet. Mund t'ju ndaloj nëse do të vë re se

1 po largoheni nga pyetja në mënyrë që të vazhdojmë të qëndrojmë
2 të përqendruar tek ajo që dëshirojmë të mësojmë prej jush.

3 Ju rikujtoj se mund të mos pranoni të jepni përgjigje për
4 pyetje të cilat mund t'ju fajësojnë.

5 I kuptoni të gjitha këto?

6 DËSHMITARI: Po.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
8 rregull.

9 Dëshiroj t'ju jap tani disa këshilla praktike për
10 dëshminë tuaj z. Krasniqi.

11 Gjithçka që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet,
12 prandaj ju lutem flisni sa më afër mikrofonit që keni përpara,
13 flisni ngadalë dhe flisni qartë. Kjo do t'u japë mundësi
14 përkthyesve që të përkthejnë gjithçka që thoni ju.

15 Duhet të filloni të flisni vetëm pasi personi që jua bën
16 pyetjen ka përfunduar. Kur të ketë mbaruar pyetja, ju lutem
17 numëroni me vete deri në pesë. Mund t'ju duket si diçka jo
18 normale, por vetëm atëherë filloni të përgjigjeni. Sepse kjo
19 pauzë prej pesë sekondash është shumë e rëndësishme për ne që
20 të përcjellim siç duhet atë që ju thoni.

21 Nëse do të ngre dorën kështu, mos flisni më. Do përpiqem
22 mos të flas sepse nëse flas të dy kemi mbivendosje dhe pastaj
23 përkthyesit nuk përkthejnë siç duhet. Sepse përkthyesit mund
24 të përkthejnë kur flet një person, por jo kur flasin dy e më
25 shumë.

1 Nëse keni pyetje ose nëse keni nevojë për pushim apo nëse
2 ju duhet diçka tjetër, mjafton të ngrini dorën dhe unë do t'ju
3 jap fjalën të na shpjegoni se për çfarë keni nevojë.

4 I kuptuat të gjitha këto z. Krasniqi?

5 DËSHMITARI: Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
7 mirë.

8 A flisni anglisht z. Krasniqi?

9 DËSHMITARI: Jo, shumë pak.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 pak. Po nëse thoni "shumë pak" do të thotë - ta zëmë se unë
12 flas anglisht, kuptoni diçka, paksa?

13 DËSHMITARI: Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
15 Në rregull atëherë, do të shikojmë se si do të veprojmë.

16 E bëra këtë pyetje sepse mund të ndodhë që të kërkoj që
17 t'ju shoqërojnë të dilni nga salla nëse do të na duhet të
18 diskutojmë për ndonjë pyetje para se t'i përgjigjeni. E bëjmë
19 këtë për të mos influencuar te dëshmitari lidhur me përgjigjen
20 që do të japë dëshmitari.

21 Si me çdo dëshmitar do t'ju kërkoj tani që të lexoni me
22 zë deklaratën solemne për të thënë të vërtetën.

23 Ju kujtoj se përbën vepër penale në juridiksionin e
24 Dhomave të Specializuara dhënia e dëshmisë së rreme. E kuptoni
25 këtë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 24

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë.

4 Znj. Asistente e sallës, ju lutem ndihmojeni dëshmitarin
5 me tekstin e deklaratës solemne.

6 Z. Krasniqi mund ta lexoni tekstin.

7 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshminë time
8 dhe vështirësisë [siç u tha] time ligjore deklaroj solemnisht
9 se do të them të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, të vërtetën
10 dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

11 DËSHMITARI: SELATIN KRASNIQI

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Faleminderit z. Krasniqi. Jeni tani nën betim për të thënë të
14 vërtetën.

15 Mund të fillojmë atëherë me dëshminë e z. Krasniqi. Do të
16 fillojmë që t'i bëjë Avokati i Mbrojtjes.

17 Z. Avokat, keni vlerësuar se ju nevojiten dy orë për
18 dëshminë. Si zakonisht informojeni Trupi Gjykses nëse ka
19 ndryshime lidhur me këtë.

20 Keni fjalën.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës.

22 Pyetje nga z. Von Bone:

23 Py. Mirëdita z. Dëshmitar.

24 Z. Dëshmitar, a ju kujtohet se kur kanë ndodhur sulmet e
25 NATO-s në Kosovë.

1 Pë. Po më kujtohet. Më 24 mars 1999.

2 Py. A ju kujtohet se ku ndodheshit ju vetë aso kohe?

3 Pë. Atë natë isha në shtëpinë time në Zllash.

4 Py. A ndodheshit aty vetëm apo me persona të tjerë?

5 Pë. Jo, kam qenë unë, kanë qenë edhe disa të tjerë.

6 Py. Cila ishte arsyeja - pra, ishte arsyeja që ndodheshit në
7 Zllash? Banonit në Zllash apo?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Mjafton të bëni pyetje pa sugjeruar përgjigje të mundshme.

10 DËSHMITARI: Jo, unë isha dalë dikun në nëntor të 1998 në
11 Zllash.

12 Z. VON BONE: [Përkthim]:

13 Py. Po cila ishte -- për çfarë arsye ishit dalë në Zllash në
14 1998?

15 Pë. Po dikun në 1998, në korrik në mes të korrikut dhe
16 fillimit të shtatorit Ushtria Çlirimtare e Kosovës kërkoi nga
17 prindërit e mi, nga axha, axhallarët, t'jua lirojmë shtëpinë.
18 Edhe personi që e liruan shtëpinë ka qenë Rrahman Dini, me
19 pseudonimin Bali. Dhe më pas, unë si i ri kam mbajtur ka pak
20 armatim, veshmbathje dhe disa sende dhe policia serbe e mori
21 vesh në nëntor 1998, na arrestoi. Por pas dy-tri orëve baba
22 intervenoi, më liruan dhe ika dola në Zllash.

23 Py. Pyetja ishte, domethënë kjo për të cilën ju folët ka
24 ndodhur në Zllash apo ndodhi në ndonjë vend tjetër?

25 Pë. Në Prishtinë.

1 Py. Po pse shkuat pikërisht në Zllash?

2 Pë. Po aty, aty e kisha vendin dhe aty shkova. Nuk kisha ku
3 shkoj tjetër.

4 Py. Vendi ku ndodheshit në Zllash, ku ishit ju në Zllash
5 ishte vend që ishte në pronësi të juajën apo në pronësi të
6 familjes?

7 Pë. Në pronësi të familjes time.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] z.
9 Avokat.

10 Z. Dëshmitar hiqini dëgjuesit ju lutem.

11 Z. Avokat, a mund t'i bëni pyetje thjesht kujt i përkiste
12 shtëpia.

13 Po jo, ju ja propozoni përgjigjen. Nuk dua të ndërhyj,
14 cila ishte arsyeja, kujt i përkiste apo në pronësi të kujt
15 ishte, këto lloj pyetjesh do të ishin më të përshtatshme.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Po mendova që përgjigja ishte
17 dhënë më përpara, prandaj. Megjithatë --

18 Py. Shtëpia apo vendi ku keni qëndruar në Zllash, kujt i
19 përkiste, në pronësi të kujt ishte?

20 Pë. Në pronësi të mixhës.

21 Py. Prej sa kohe ishte në pronësi të mixhës?

22 Pë. Prej 1920.

23 Py. Ju kuptova.

24 Pë. Ndoshta gabova 1928, më falni.

25 Py. Edhe anëtarët e tjerë të familjes qëndronin aty, në atë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Page 27

1 shtëpi, në shtëpinë e mixhës?

2 Pë. Deri në vitin 1990 kanë qëndru në fshatin Zllash. Në 1990
3 kanë dalë në Prishtinë edhe axha edhe na, baba jem me familje.

4 Py. Derisa ishit në Zllash, ishte edhe mixha aty?

5 Pë. Po. A po më pyet për 1999 apo 1990?

6 Py. Për vitin 1999.

7 Pë. Jo në 1999 nuk kanë qenë.

8 Py. Ju kuptova.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
10 falni për mua nuk është e qartë. Gjatë periudhës që ju vetë
11 ishit në Zllash, pra nga nëntori 1998 kush ishte bashkë me ju
12 në Zllash?

13 DËSHMITARI: Po ka pasë disa persona janë kanë, 20, 30,
14 50.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
16 më falni e kam fjalën në shtëpinë ku vetë ju po jetonit aty në
17 Zllash?

18 DËSHMITARI: Ka qenë Rrahman Dini, Isa Kastrati, Shpend
19 Canolli. Basri Canolli në realitet, se Shpend e ka pasur
20 pseudonimin. Ka qenë Sylja. Që më vonë e kam kuptue emrin e
21 tijna e ka pas Besnik Maroca. E shumë të tjerë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase
23 unë vetë nuk isha e qartë. E kisha fjalën për anëtarët e
24 familjes juaj vetë. Në atë shtëpi ku keni qëndruar edhe ju. Se
25 në fakt nuk e kisha shumë të qartë nga pyetja që bëri Avokati

1 i Mbrojtjes. Pra, nga familja juaj kush tjetër ndodhje aty?

2 DËSHMITARI: E nderuar Gjykatëse, prej 1990 familjarët e
3 tonë, pos pushimeve, domethënë verë - gjatë verës kena qëndru
4 3 muj dikë, s'kena ndejt ma shumë atje. Shtëpia ka qenë e
5 lirë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prapë
7 nuk mora përgjigje për pyetjen time. Nga nëntori 1998 e më
8 tutje, pra 1998 që ju shkuat në Zllash, keni dalë në Zllash,
9 kush tjetër, anëtar i familjes tuaj, tënde, nëse kishte
10 sigurisht, ishte gjithashtu në Zllash me ju atje?

11 DËSHMITARI: As edhe një s'a kanë, kurrkush, veç unë jam
12 kanë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Z. Avokat keni fjalën.

16 Z. VON BONE: [Përkthim]:

17 Py. Pra në nëntor të vitit 1998 ka ndodhur kjo. Më pas në
18 vitin 1999 dhe në pas, ka ndodhur ndonjë herë që janë dalë aty
19 edhe anëtarët e tjerë të familjes tuaj dhe nëse po, kush prej
20 tyre?

21 Pë. Po me 1 prill ose 2, tash mund të mos jem i saktë, pas
22 depërtimit të Prishtinës, a kanë baba jem, nëna dhe motra. Një
23 pjesë e familjes, jo krejt familja.

24 Py. Deri në ç'datë apo deri kur qëndruan ata aty?

25 Pë. Kanë ndejt nja 3 ditë dhe unë kam kërku prej babës me

1 shku dikun tjetër. Pasi që ishim të fshatit dhe kishte mundësi
2 baba me shku në një lokat tjetër, aty afër dhe me i liru dy,
3 tre vende.

4 Py. Po përse - jo, më falni. Ku shkuan anëtarët e familjes?

5 Pë. Shkuan afër aty dikun 250 metra në një lagje, quhet lagja
6 Cubaj. Edhe aty kanë qëndru deri në ofensivë.

7 Py. Afërsisht a ju kujtohet se kur filloi ofensiva?

8 Pë. Fillon me 17, ka fillu. Domethënë Prapashticë e në ato
9 fshtrat tjetër, ka fillu ma herë, por në Viti të Marecit ka
10 fillu me 17, në qoftë se nuk gaboj.

11 Py. Në datë 17 të cilit muaj dhe cilit vit ka ndodhur?

12 Pë. Prill 1999.

13 Py. Faleminderit shumë. Nga data 24 mars që është data e
14 bombardimeve të NATO-s deri më 17 prill, në Zllash keni
15 qëndruar?

16 Pë. Po, në 26 ose 27 mars kena shku në Prishtinë. Unë pasi
17 jam konë i asaj ane e kam ditë pak terrenin. I kam çu disa
18 grupe deri në fshatin Butovc. Disa i kam lënë në Mramor te
19 lagja e Kollçakëve, ashtu thirret. Edhe mas mbrëmjes jam hi
20 edhe vetë në Prishtinë me disa persona.

21 Py. Sa kohë qëndrove në Prishtinë.

22 Pë. Nëse nuk gaboj deri me 30 kena qëndru ose deri më 1, nuk
23 jam i saktë me datë.

24 Py. Po pastaj ku keni shkuar?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 30

1 cilit muaj bëhet fjalë, këtë datën, z. Avokat? Se unë nuk e
2 kam të qartë për cilin muaj.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Është --

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] jo,
5 jo pyeteni.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]:

7 Py. Thatë 30 mars. Jo më falni, kërkoj ndjesë. Kërkoj ndjesë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
9 kuptova, e kuptova, që ishte gabimi.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]:

11 Py. Thatë dhe më datë 30, deri më 30. 30 të cilit muaj, të
12 cilit vit?

13 Pë. Mars 1999.

14 Py. Pastaj nga ai më moment e më tutje, ku keni shkuar. A
15 qëndruat aty, a lëvizët?

16 Pë. Unë kam qëndruar në Prishtinë, afër Medresës. Edhe një
17 mëngjes ka ardhur një shok i imi nga Kodra e Trimave dhe më ka
18 thirrë, më ka thënë se forcat serbe janë në Kodrën e Trimave,
19 hajde. Jena dalë në Vranjec, e kam taku Shpendin. Edhe më ka
20 sugjeru që me urdhër të Rrahman Dinit, komandant Calit edhe të
21 Fatmir Humollit, është që ne mos me bë diçka, mos me gjujt,
22 mos me shti na në serb, me e qetësu popullatën edhe me e
23 ndihmu.

24 Py. E kuptoj, e kuptoj, por nuk ishte kjo pyetje. Pyetja
25 ishte e thjeshtë. Keni shkuar nga Zllashi në Prishtinë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 31

1 Qëndruat aty, pastaj nga Prishtina ku keni shkuar? Vazhduat të
2 qëndronit në Prishtinë apo keni lëviz diku.

3 Pë. Jo, kena lëviz në Zllash.

4 Py. Pra, jeni kthyer në Zllash. Kur jeni dalë prapë në Zllash
5 ishte e njëjta ditë?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
7 ta pyesni kur ka shkuar sërish në Zllash?

8 Z. VON BONE: [Përkthim]:

9 Py. Lëvizët prej Prishtinës, kur mbërritët në Zllash?

10 Pë. Kam mbërrit diku në tre, në katër të mëngjes, në datën 1,
11 nëse s'gaboj. 1 prill.

12 Py. Të vitit 1999, ma merr mëndja?

13 Pë. Po.

14 Py. E sa kohë qëndruat në Zllash.

15 Pë. Aty mase dikun tri-katër ditë kemi ardhur prap në
16 Prishtinë. Domethënë masi ka kalu familja në atë shtëpinë ku e
17 ceka më herët. Jam ardh në Prishtinë, kam marrë disa gjëra
18 ushqimore për familjen dhe jam kthy prapë në Zllash.

19 Py. Në të njëjtën ditë?

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
21 ta pyesni se kur?

22 Z. VON BONE: [Përkthim]:

23 Pë. Me datën 3 ose 4 ka mund me ndodh ai send.

24 Py. Të cilit muaj?

25 Pë. Prill.

1 Py. Të vitit 1999, ma merr mendja.

2 Pë. Po.

3 Py. Faleminderit. Ju kërktoj ndjesë, thjesht dua të sigurohem
4 që t'i kemi në procesverbal.

5 Pë. Folëm për [e pakuptueshme].

6 Py. Kur mbërritët, kur shkuat në Zllash, pasi shkuat aty,
7 personat e tjerë për të cilët ju folët, të cilët i cekët, Isa
8 Kastrati, Rrahman Dini, çfarë bënëin ata aty?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Hiqini dëgjueset ju lutem.

11 Z. Avokat, ju lutem a mund të përcaktoni për cilën kthim
12 e keni fjalën se ai -- se nëse e vërej mirë ai u kthye më 1
13 prill, u largua dhe pastaj u kthye prapë. Prandaj për mua nga
14 pyetja nuk është e qartë se për cilin prej këtyre kthimeve e
15 keni fjalën.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] E kuptoj, do ta bëj pyetjen
17 ndryshe.

18 Py. Z. Dëshmitar, folëm më herët për datën 24 mars. Na thatë
19 më herët se qëndruat me disa njerëz aty. Këta persona të cilët
20 ju i cekët, Isa Kastrati dhe Rrahman Dini, në fakt çfarë po
21 bënëin ata në atë vend aty në Zllash?

22 Pë. Po ata janë kanë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës, kanë ndejt aty. Nuk ka kenë detyrë e imja me pyet
24 ç'ka po bënë.

25 Py. Ju kuptoj. Ku flinin, për shembull?

1 Pë. Po aty janë kanë -- ka pasë dhoma domethënë katër në
2 njëërën pjesë, dy janë kanë në njëërën pjesë. Ka pasur vend sa
3 të duash.

4 Py. Si ka mundësi që ata mund të qëndronin në atë vend aty?

5 Pë. S'po e kuptoj pyetjen "si ka mundësi?".

6 Py. Në pronësi të kujt ishin këto shtëpia?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Avokat po flasim për një shtëpi, jo shumë shtëpia.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po tha kishte një sërë dhomash
10 dhe kishte dhe dhoma të tjera.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
12 mos e nënkuptoni, pyeteni.

13 Z. VON BONE: [Përkthim]:

14 Py. Në atë vend aty sa afërsisht, sa shtëpi apo ndërtesa
15 ishin?

16 Pë. Në atë lokacion kanë qenë dikun gjashtë dhoma të fjetjes,
17 që janë konë të gatshme për fjetje.

18 Py. Brenda të njëjtës shtëpi janë këto, një shtëpi bëhet
19 fjalë apo ishin më shumë?

20 Pë. Ka qenë shtëpia dhe ka qenë një pjesë tjetër që na i kena
21 thënë odë.

22 Py. A mund të na shpjegoni çfarë është oda?

23 Pë. Oda ka shërby në kohët e përpara vetëm për burra nëpër
24 fshatra. Kur kanë ardh mysafirët.

25 Py. Çfarë bënin burrat në odë?

1 Pë. Kanë bisedu, kanë.

2 Py. Faleminderit shumë.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Në këtë moment dëshiroj që të
4 kërkoj t'i tregojmë një fotografi dëshmitarit me numër
5 DSM00026.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
7 të vazhdoni znj. Sekretare.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju lutem ta zmadhojmë paksa.
9 Mbase edhe më shumë. Faleminderit.

10 Py. Z. Krasniqi e shini këtë fotografi?

11 Pë. Po.

12 Py. E njihni këtë vend?

13 Pë. Po, shumë mirë e njoh.

14 Py. Mund të na thoni se çfarë është ky vend?

15 Pë. Ky vend është në fshatin Zllash, shtëpiat tonat që kanë
16 qenë.

17 Py. Për këtë vend e kishit fjalën tani kur sapo thatë që --
18 pra në këto shtëpi ka qëndruar Rrahman Dini, Shpendi?

19 Pë. Po.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
22 Avokat ju lutem vazhdoni, po kur të përfundoni me fotografinë
23 do të doja që t'i ktheheshim edhe një herë një pyetje që u bë
24 pak përpara. Ju lutem vazhdoni për momentin.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] në rregull.

1 Py. A mund të na shpjegoni se çfarë objektësh po shohim,
2 çfarë ndërtesat po shohim në këto fotografi?

3 Pë. Po e shohim hambarin, odën në një dhomë që a kanë.

4 Py. Më lejoni t'ju ndërpres për një moment sepse do të ishte
5 e paqartë në qoftë se do t'i thonit në këtë mënyrë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Avokat a të sugjeroj që t'i japim një laps, një marker
8 dëshmitarit?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Kam një pyetje përpara se ta t'i
10 japim lapsin dëshmitarit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull. Mirë, bëjeni pyetjen dhe Sekretarja kur të jetë e
13 nevojshme mund ta ndihmojë dëshmitarin me lapsin.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase është më mirë që këtë
15 pyetje ta bëjmë më pas sepse do ta kemi më të qartë atë çfarë
16 dua që të identifikoj unë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është
18 marrja juaj në pyetje, kështu që vendosni juve se cilën pyetje
19 të bëni më përpara.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Ndoshta mund ta zmadhojmë pak
21 fotografinë.

22 Py. A mund ta shihni mirë fotografinë z. Dëshmitar?

23 Pë. Po, po. Mirë.

24 Py. Nëse do të nisim, për shembull, nga e djathta e kësaj
25 fotografie, në cep në të djathtë, duket se ka shumë pemë. Por,

1 ajo çfarë po përpigëm unë të verifikoj janë këto pjesët e
2 mbetura të godinave më përpara. Ju lutem duke filluar nga
3 pjesa e sipërme në të djathtë deri në fund, a na thoni se
4 çfarë kanë qenë këto struktura?

5 Pë. Kjo është --

6 Py. Më falni. Mirë në rregull, vazhdoni.

7 Pë. Kjo është këtu, maqina, domethënë kombajna me një fjalë,
8 që ka qëndru.

9 Py. A mund ta shënjoni me 1 ju lutem. Vendosni një "1" aty.

10 Në të djathtë të shënimit që bëtë, a mund të na e
11 shpjegoni se çfarë janë strukturat në të djathtë të saj?

12 Pë. Këtu ka qenë një dhomë.

13 Py. Vetëm një dhomë ka qenë aty apo ka pasur më shumë dhoma?

14 Pë. Deri këtu kanë qenë të katërta.

15 Py. Në rregull. Ju lutem a mund të vendosni numrin 2 tek
16 rrethi dhe tek ky katërkëndori ju lutem të vendosni numrat 3,
17 4 dhe 5.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
19 ta kuptuar unë.

20 Z. Dëshmitar, shifrat 2, 3, 4, 5, ju sapo thatë që aty ka
21 pasur dhoma. A e kuptoj drejt që këto i përkasin së njëjtës
22 shtëpi, janë të së njëjtës shtëpi?

23 DËSHMITARI: Po, po [e pakuptueshme].

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra
25 ishte një shtëpi dhe ju po na tregoni dhomat e ndryshme që ka

1 pasur një shtëpi?

2 DËSHMITARI: Po, po.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]:

4 Py. Kush ishte i zoti i kësaj shtëpi?

5 Pë. Po fol para 1998?

6 Py. Po flas për periudhën përpara 1998, në rregull.

7 Pë. Këtu ka qenë shtëpiat kanë qenë të Adem, Adem Krasniqit.

8 Në fletë poseduese kanë qenë në emër të Kadri Krasniqit.

9 Domethënë vllazëni kanë qenë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila

11 është pjesë tjetër, nuk e kam të qartë se çfarë do të thuash

12 kur thua "pjesa tjetër"?

13 DËSHMITARI: Pjesa tjetër... në fletë poseduese, thashë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,

15 kjo shtëpi i përkiste Adem Krasniqit, por pjesa tjetër ishte

16 në emrin e Kadri Krasniqit.

17 Pyetje që bëra unë më pas është që çfarë do të thuash t'i

18 me "pjesën tjetër"?

19 DËSHMITARI: Jo, pjesa tjetër.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ku

21 reflektohet në fotografi pjesa tjetër?

22 DËSHMITARI: Në dokumenta fola, ka qenë në emër të Kadri

23 Krasniqit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishin

25 të dy pronarë të së njëjtës ndërtesë, ishin bashkëpronarë?

1 DËSHMITARI: Po, po.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset.

4 Z. SHALA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk është në
5 përkthim. Ai tha "në listën e zotërimit". Dhe kjo është një
6 listë që tregon se kush është pronar. Domethënë ai shpjegoi që
7 pronari real është Ademi, ndërkohë që në dokumentet e
8 regjistruar në kadastër reflektohet ose paraqitet dikush
9 tjetër si pronar. Por pronari real është Adem.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Këtë
11 nuk është se e kuptova kështu.

12 Z. SHALA: [Përkthim] Nuk e kemi në përkthim këtë fjalë,
13 pra "listën poseduese".

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
15 kontrollojmë këtë.

16 Z. Avokat, ju lutem vazhdoni do t'i kërkoj gjithashtu
17 dëshmitarit që të vendosë kufjet.

18 Z. VON BONE: [Përkthim]:

19 Py. Nëse do të shoh 2, 3, 4 dhe 5, këto janë të gjitha në një
20 ndërtesë, në një godinë, kështu është?

21 Pë. Po.

22 Py. Kjo ndërtesë me këto dhomat ishte pronë e familjes tënde.
23 Kështu është?

24 Pë. Po.

25 Py. Po struktura që është poshtë 5-s, çfarë është që është në

1 të njëjtën linjë, në të njëjtën rresh, në të njëjtën rend,

2 çfarë është kjo pamje?

3 Pë. Këtu ka qenë një stallë e bagëtisë që kanë mbajtur deri në
4 vitin 1990. Dhe me numrin 5, kanë qenë dy dhoma domethënë.

5 Oxhaku që e kanë përdorur për --

6 Py. E kuptoj. Dua t'ju ndërpres këtu. Stalla për - ju lutem,
7 këtë stallën që thatë a mund ta shënoni me numrin 6?

8 Pë. [Shënon].

9 Py. Shumë faleminderit. Nuk e di tamam se si ta shpreh këtë
10 me fjalë, por në të majtë të kësaj, pra në të majtë të
11 ndërtesës me numrin 6, duket sikur është një tjetër strukturë.
12 Është si pingul.

13 Pë. Po. E ke fjalën për këtë?

14 Py. Po, për këtë e kam fjalën. A mund të na thuash se çfarë
15 ka qenë kjo dhe po ashtu të lutem, a mund të vendosësh numrin
16 7 aty?

17 Pë. Kjo ka qenë ma - domethënë në vitet 1980 unë nuk e di,
18 tash kanë thonë se ka qenë shtëpi banimi. Dikur e kanë bërë
19 për garazh.

20 Py. Në rregull. Dua t'ju pyes, në periudhën nga marsi deri në
21 prill 1999, kjo struktura që reflektohet me 2, 3, 4 dhe 5, a
22 kanë qenë të paprekura, kanë qenë në gjendje të paprekur?

23 Pë. Po.

24 Py. Në rregull. Po struktura me shifrën 6, ka qenë edhe kjo e
25 paprekur?

1 Pë. Fillimi, kur a kanë oxhaku këtu, kur kjo a kanë e mirë e
2 kënejna poshtë ka qenë e shkatërrume tërësisht. S'kena muj me
3 e ndreqë.

4 Py. Në rregull. Po tek pika 7, kjo strukturë në mars dhe në
5 prill 1999 ishte ekzistuese?

6 Pë. Po.

7 Py. Sa e lartë mesatarisht ishte kjo godinë në qoftë se mund
8 të bëni një vlerësim të përafërt

9 Pë. Për numrin 7 e keni fjalën?

10 Py. Po, për numrin 7.

11 Pë. Ndoshta 2.20-2.30, s'po di saktë, s'e di. Veç ke mujt me
12 ec në këmbë.

13 Py. Nëse shkojmë nga numri 6 e më poshtë, duket sikur ka
14 sërish një lloj strukture aty. Çfarë do ishte kjo. Çfarë është
15 kjo?

16 Pë. Për këtë e ke fjalën.

17 Py. Po, për këtë e kam fjalën.

18 Pë. Këtu ka qenë një mur. Është muri kështu.

19 Py. E kuptoj. A mund të vendosni numrin 8 aty ju lutem?

20 Pë. [Shënon].

21 Py. Ky muri për çfarë përdorej?

22 Pë. Muri oborrit që ka qenë. Veç që kjo është pjesë kështu a
23 kanë.

24 Py. E kuptoj. Në rregull. Në të majtë të numrit 8, menjëherë
25 pas numrit 8, çfarë ka aty, çfarë mund të shoh aty?

1 Pë. Deri këtu?

2 Py. Po për këtë e kam fjalën.

3 Pë. Këtu ka qenë hyrja. Hyrja në oborr.

4 Py. E kuptoj. Ju lutem a mund të vendosni numrin 9 aty?

5 Pë. [Shënon].

6 Py. Z. Dëshmitar, nëse do të ecja nga 7 deri tek 9, ju lutem
7 a mund të më përshkruash se si do ishte kjo?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mos
9 ja jepni përgjigjen.

10 Z. VON BONE: [Përkthim]:

11 Py. E kuptuat pyetjen?

12 Pë. Jo.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
14 lutem, riformulojeni, por riformulojeni pa dhënë përgjigje. Ju
15 lutem më lejoni të flas.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

17 Py. Nga 7 deri tek 9, sa është larg është nga 7 deri te 9
18 mesatarisht.

19 Pë. 7, 8 metra 10, s'ka më shumë.

20 Py. Në rregull. Si është fusha aty në qoftë se ecën me këmbë
21 nga 7 deri tek 9?

22 Pë. Prej 9 sidomos është rrafsh pastaj vazhdon pak përjetë.

23 Py. Dhe vazhdon pak përjetë deri ku?

24 Pë. Deri te 7, domethënë shkon.

25 Py. E kuptoj.

- 1 Atëherë e marrim si pikë nisëse pikën 9 dhe shkojmë në
2 skajin në të majtë. Shoh që ka disa struktura ekzistuese aty.
3 Ju lutem, a mund të na e tregoni? A mund të vendosni numrin 10
4 aty, ju lutem.
- 5 Pë. Kjo ka qenë ushqimin për stallë që kanë lanë. I ka pasë
6 dy hyrje.
- 7 Py. Në rregull. E kuptoj.
- 8 Pë. Njërën e ka pasur këtu edhe njërën mbrapa.
- 9 Py. E kuptoj. Menjëherë sipër numrit 10 --
- 10 Pë. Po.
- 11 Py. -- a mund ta tregoni këtë objektin që është sipër 10-ës.
12 Menjëherë sipër 10-s. A mund të shënoni numrin 11?
- 13 Pë. [Shënon].
- 14 Py. Çfarë është kjo?
- 15 Pë. Kjo ka qenë kanë lënë pajisjet bujqësore.
- 16 Py. Në rregull. Sipër numrit 11, ju lutem a mund të na
17 tregoni strukturën tjetër? A mund të vendosni shifrën 12 ju
18 lutem?
- 19 Pë. [Shënon].
- 20 Py. Çfarë ka qenë numri 12?
- 21 Pë. Mendoj se ka qenë ajo oda si të thashë dhe ka pasë dhe
22 një dhomë tjetër afër aty.
- 23 Py. Në rregull. Menjëherë sipër numrit 12, a mund ta shënioni
24 objektin? Po faleminderit.
- 25 Pë. [Shënon].

1 Py. Çfarë ka qenë kjo, çfarë ka qenë numri 13?

2 Pë. Ky ka qenë hambari që kanë lënë grurin, tërshanën e këto.

3 Py. E kuptoj. Sipër numrit 13 çfarë ka qenë?

4 Pë. Kjo në atë kohë i kanë thënë çiller [fon], e kanë lënë
5 qumështin, djathin, këto.

6 Py. E kuptoj. A mund ta zvogëlojmë? Atëherë mirë, nuk duhet
7 ta zmadhojmë, thjesht do ta mbajmë kështu siç e kemi sepse në
8 të kundërtën mund t'i humbin të gjitha shifra.

9 Më lejoni ta formuloj kështu, në qoftë se do të shoh
10 strukturën që është shënuar me numrin 6. Në qoftë se do të
11 shkoj në të djathtë fare të fotografisë, shikoj që ka shumë
12 sipërfaqe të gjelbra. A mund të na thoni se çfarë është kjo
13 sipërfaqe e gjelbër?

14 Pë. E ke fjalën për [e pakuptueshme]?

15 Py. Po, nga aty edhe më andej.

16 Pë. Këtu ka qenë një shtëpi deri në 1995, 1996, edhe knejna
17 është mal.

18 Py. Në rregull. Në periudhën nga marsi në prill të vitit
19 1999, a mund të na thoni - jo.

20 Së pari, edhe një herë, numri 6, prilli 1999. Ndërtesa
21 numër 6 a ishte në përdorim? A përdorej në ndonjë farë forme
22 apo trakte në atë kohë?

23 Pë. Jo. Ke mujt veç nëse bjen shi me hi pak me ndej, se jo.

24 Py. Në rregull. Numri 2, 3, 4, 5 këto kanë qenë në përdorim
25 në atë kohë?

1 Pë. Po.

2 Py. Kush i përdorte ato?

3 Pë. Po të gjithë ne që kemi qenë aty.

4 Py. Kur thoni "të gjithë ne që kemi qenë aty" për kë e keni
5 fjalën?

6 Pë. Po ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë kanë qenë. Ka
7 qenë një pjesë e Karadakut, ka qenë një pjesë Rrahmn Dini me
8 disa shokë. Isa Kastrati, mos i ngjej me emra se dalin shumë.

9 Py. Si ishte e mundur që ata kishin mundësi të qëndronin
10 atje?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e
12 kuptoj pyetjen. Çfarë do të thuash "që si ishte e mundur"?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Do ta formuloj ndryshe, e nderuar
14 Gjykatëse.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]:

18 Py. A lejoheshin këta persona që të rrinin atje dhe të flinin
19 atje.

20 Pë. Po lejoheshin se pasi kam biseduar me prindërit e mi, me
21 axhën, me axhallarët dhe ma babën këta janë leju dhe kanë
22 qëndru aty. A kanë shtëpia e tyre.

23 Py. Kjo ishte shtëpia e tyre në periudhën e marsit dhe të
24 prillit 1999?

25 Pë. Prej gushti, 15 gushtit, nëse nuk gaboj 1998, deri në

1 përfundim të luftës, e tyne a kanë.

2 Py. Dhe cila - cilës periudhës i referoheni ju si fundi i
3 luftës?

4 Pë. Po me, tash 23, sot 23 vjet domethënë kemi dalë prej
5 atyhi dhe a kanë shkatërru forcat serbe.

6 Py. E kuptoj. Thjesht desha të dija kohë se thatë "nga
7 fillimi deri në fund të luftës". Për juve kush është pika e
8 fundit të luftës në këtë kuadër kohe?

9 Pë. 12 qershori është pika e fundit e luftës, 1999.

10 Py. Shumë faleminderit. Që prej kur lejoheshin këta persona
11 që të qëndronin aty, Rrahman Deni, Isa Kastrati dhe personat e
12 tjerë që cekët?

13 Pë. E ceka dikun 15 gushti 1998, muj me gabu dy-tri ditë, por
14 jo ma shumë.

15 Py. Në rregull, e kuptoj. Në periudhën mars-prill 1999 ku ke
16 qëndruar ti në këtë vend kur ke qenë atje, kuptohet? Në qoftë
17 se ishit atje, ku qëndronit?

18 Pë. Po në fillim sa s'ka pasur të ardhur të tjerë, kam
19 ndenjur në 3, 4, 2 edhe në 12 kam fjetë. Ama këtu te 12 kanë
20 qenë dy dhoma që e cekëm. Ka pasë...

21 Py. Përmendët Rrahman Dinin dhe të tjerët.

22 Pë. Po.

23 Py. Ata a i përkisnin një njësitit të caktuar? A ishin
24 pjesëtarë të UÇK-së ata?

25 Pë. Pjesëtarë të UÇK-së.

1 Py. E kuptoj. Dhe cilës pjese të UÇK-së i përkisnin ata.

2 Pë. Ma vonë e kam kuptuar që ka qenë pjesë e Brigadës 153. Se
3 nuk më ka interesu as me pyet [e pakuptueshme] kam pasur të
4 njëjtin qëllim krejt edhe s...

5 Py. Në rregull. Cekët personat besoj nga Zona e Karadakut, në
6 qoftë se e mbaj mend siç duhet.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e kam numrin e referencës.

8 Py. Por përmendët persona nga Zona e Karadakut. Këta persona
9 ishin nga a njëjta brigadë apo ishin pjesë e një brigade
10 tjetër?

11 Pë. Jo, jo këta deri që kanë formu zonën e vet kanë qëndru
12 një pjesë e tyre edhe aty në shtëpinë tonë.

13 Py. Në rregull.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Referenca është në faqen 40, rreshti 9, ku dëshmitari përmend
16 pjesën e Karadakut.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]:

18 Py. A kishte persona të tjerë të cilët e përdornin këtë që ju
19 e dini që i përkisnin një zone tjetër, brigadave të tjera?

20 Pë. Por të tjerë s'ka pasë, kanë qenë të Karadakut, në
21 përgjithësi të Gollakut këta të tjerët.

22 Py. E kuptoj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për

24 ta kuptuar unë, Avokati ju pyeti në qoftë se kishte persona të
25 tjerë dhe kur flisni dhe kur cekët njerëzit ose personat e

1 tjerë e keni fjalën për civilët, e keni fjalën për ushtarët, e
2 keni fjalën për të dyja kategorisë?

3 DËSHMITARI: Po, ka pasur edhe civilë. Mbas 1 prillit ka
4 pasur edhe civilë shumë atje.

5 Z. VON BONE: [Përkthim]:

6 Py. Afërisht sa civilë ka pasur aty? Nëse mund të jepni një
7 shifër të përafërt?

8 Pë. Mbi 100 vetë janë kanë kur janë çu dikun me datën 1 prill
9 nga ora 10.00 në mëngjes kur kanë dalë në oborr, mbi 100 vetë
10 janë kanë. Ka pasur gra, fëmijë.

11 Py. Nga kishin ardhur gjithë këta njerëz?

12 Pë. Të gjithë prej Prishtinës kanë ardh.

13 Py. Pse kishin ardhur atje ata?

14 Pë. Pse forcat serbe i larguan prej shtëpijave të tyre në
15 Prishtinë. I dëboi me dhunë dhe dikah duhet me dalë ata.

16 Py. Pse kishin zgjedhur që të vinin në atë zonë?

17 Pë. Po në atë kohë nuk ka pasur luftë [e pakuptueshme] mes
18 vdekjes dhe shpëtimit ka qenë pak më [e pakuptueshme] me vdek
19 në Prishtinë.

20 Py. Sa kohë qëndruan aty këta njerëz, këta civilë?

21 Pë. I nderuar Avokat, kjo shtëpia këtu në Zllash është e --
22 kufizohet me disa fshatra të tjerë. Edhe mbrapa këtu numrit 1
23 është një rrugë që të pon në Prapashticë në Keçekollë, Marec.
24 Domethënë është një rrugë transite. Kanë ndenjtë civilë këtu
25 dy ditë, tri ditë i kena përcjellë kush ka pasur në të afërm

1 në një fshat tjetër, kanë ardhur të tjerë, e kështu me radhë.

2 Py. Ju kuptoj. Kur thoni --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
4 moment, z. Avokat. Në fillim të merrni një përgjigje se sa
5 kohë qëndruan aty këta njerëz, këta civilë se nuk mora
6 përgjigje për këtë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim]:

8 Py. Z. Dëshmitar -

9 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duket se e tha, dy deri në tre
11 ditë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
13 mirë. Vazhdoni.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]:

15 Py. Thatë që "do t'i shoqëronim", "i kena shoqëru", po kush
16 janë "ne" që i kemi shoqëru?

17 Pë. Na që kena qenë aty, unë për shembull kam pasur një
18 traktor edhe ka pasë familje që i kam çu edhe në Keçekollë
19 deri në Prapashticë deri në Marec deri në Koliq, e kështu me
20 radhë. E ka pasur si unë shumë djem. U kena dhanë bukë, ushqim
21 ça kena pasë e kena përcjellë. Ka pasë fëmijë.

22 Py. Ju kuptoj.

23 Py. Njerëzit qëndronin këtu këta civilë apo shkon --

24 Pë. Ka pas edhe - po, po kanë qëndru dy-tre ditë janë ndalë
25 të tjerë, janë shku të tjerë [e pakuptueshme].

1 Py. Pra, nëse ju kuptova mirë, shkonin e vinin njerëz.

2 Pë. Po.

3 Py. Kjo vendndodhje këtu po ta shohim fotografinë dhe shoh
4 nga numri 1 deri në numrin 10 dhe pastaj nga numri 10 deri tek
5 8, pastaj nga 8 deri tek 2. Ka pasur ndonjë gardh rrethues?

6 Pë. Para vitit 1990 ka pasë. Po mas vitit 1990 nisi me u
7 shkatërriu u ka shkatërriu krejt. Këtu a kanë [e pakuptueshme].

8 Py. Nëse mundet, dua të përcaktoj edhe një herë periudhën në
9 mars dhe në prill të vitit 1999, gjatë kësaj periudhe ka pasur
10 apo s'ka pasur gardh rrethues.

11 Pë. Shumë pak, shumë pak, pjesë-pjesë ka qenë.

12 Pë. A mund të hynin e të dilnin lirisht njerëzit në këmbë në
13 këtë vend?

14 Pë. Ka kanë desht kanë mujt me ik. Nëse vijnë në drejtim të
15 numrit 12 domethënë ka qenë fushë që ka pamje dikun 1
16 kilometër ose ma shumë edhe këtu a kanë një hyrje. Te numri
17 12. Te numri 13 ka pasë hyrje. Mbi numrin 14 ka pasë hyrje.
18 Mes 1 dhe 2 ka pas hyrje. Te numri 9 ka pasë hyrje. Edhe te 10
19 te ky lisi këtu ku është, edhe sot është edhe aty ka pasë
20 hyrje.

21 Py. Ju kuptoj. Nëse flasim për numrin 9, ka pasur ndonjë
22 portë ose ndonjë tra?

23 Pë. Jo, porta a kanë po në atë kohë nuk ka ekzistuar. Domethënë
24 1998, 1999 nuk ka ekzistuar.

25 Py. E kisha në mënyrë në mënyrë specifike për muajin mars dhe

1 prill të vitit 1999. A ka pasur ndonjë portë apo tra që e

2 pengonte hyrjen?

3 Pë. Jo, jo, s'ka pasë.

4 Py. A ka pasë ndonjë person që e ruante atë vend aty?

5 Pë. Jo nuk ka pasë person që e ka ruajt këtë vend, as ka
6 pasë nevojë me e rujt këtë vend hiç. Pasi që dikun 10 km ka
7 qenë roja tjetër në Cervodik. Në Marec, në fshatin Marec, në
8 Viti të Marecit ka qenë një roje tjetër. Në Prapashticë, në
9 Keçekollë te Çelevit, në Keçekollë në Cervadikët dhe nuk ka
10 pasë nevojë me u ruajt. Me sa e di unë sa kam qëndru aty s'ka
11 pasë roje.

12 Py. Ju kuptoj. Gjatë periudhës mars-prill 1999 a ka pasë
13 rrymë elektrike në këtë vend?

14 Pë. Nëse nuk gaboj --

15 Py. Në shtëpitë aty në ndërtesat që janë këtu?

16 Pë. Nëse s'gaboj deri në janar ka pasë rrymë tani e kanë
17 ndalë serbët dikun jashtë fshatit Zllash. Ka fundi i janarit
18 ndoshta, s'di pas sa. Se edhe rryma s'na ka vy se skena pasë
19 në atë kohë as telefona këshij teknologjie, s'na ka interesu
20 për rrymë.

21 Py. Po si ndriçoheshit, çfarë ndriçimi përdornit për dhomat?

22 Pë. Po kena pasë llamba gazit ka një herë edhe s'kena pasë
23 hiç. Ka qenë edhe oxhaku, stufa janë kanë me dru.

24 Py. Ju kuptoj. A kishte aty ndonjë vend me kuzhinë me
25 përgatit ushqim?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 51

1 Pë. Po.

2 Py. Ku ndodhej në këtë fotografi?

3 Pë. Në numrin 5, thashë 6 që këtu që është, që e kam bo
4 vijën.

5 Py. Dhomat me numër 2, 3, 4 dhe 5 --

6 Z. VON BONE: [Përkthim] I lutem dëshmitarit të heqi
7 dëgjueset.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
9 Avokat.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Jam i bindur që e ka përmendur
11 bodrumin.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Këshillohuni me kolegët për të parë nëse po.

14 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë më mirë ta bëj pyetjen.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
17 të vazhdoni z. Avokat.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Z. Dëshmitar ju lutem vendosini
19 dëgjueset.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit z. Dëshmitar.

22 Z. VON BONE: [Përkthim]:

23 Py. Z. Dëshmitar po kur shoh numrin 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë
24 ndonjë ndërtesë me një kat apo ndërtesë me dy kate të themi?

25 Pë. Vetëm në numrin 5, domethënë në numrin 5 ka qenë një

1 magazinë. Niveli i tokës a kanë qashtu.

2 Py. Nuk e kuptoj, që niveli i tokës ishte i tillë.

3 Pë. Aty a kanë ma poshtë kanë pasë mundësi me nxjerrë një
4 podrum dhe e kanë nxjerrë dhe e kanë bërë magazinë të ushqimit
5 familja.

6 Py. Po pse për shembull nuk ishte në dhomën numër 2?

7 Pë. Po s'ka pas mundësi, se mjete s'ka pas me rrëmih aty, dhe
8 s'ka pasë mundësi kur është mbaru.

9 Py. Nëse do të ecja në këmbë nga numri 7 drejt numrit 2, sa
10 metra do të ishte përafërsisht?

11 Pë. 12-13 metra, 15, s'po di më shumë.

12 Py. Do t'i kthehemi tani datës 24 mars. Si e morët vesh që
13 filluan bombardimi i NATO-s me datë 24 mars të vitit 1999?

14 Pë. Unë kam qenë në dhomën 3, edhe jam kanë fjetë. Më ka
15 thirr dikush, s'po e di. Ka po thonë Isa Katrati "urime se
16 filluam bombardimet e NATO-s". U çuam prej atyhit, u gëzuam
17 pak, e vazhduam ka numri 2 te numri 1 e dolëm dikun 150 metra
18 duket një pjesë e Kosovës, prej aty pamë që filluan
19 bombardimet. Lajmin na e ka dhënë Isa Kastrati.

20 Py. Ju kuptoj. Pra kur po shkonit aty ku thatë --

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Sa ta gjej, një moment.

22 Py. Si mund të shihet nga ajo pikë bombardimi, si është e
23 mundshme.

24 Pë. Po këto 150 metra të këtij lokacioni ma të lartë aty,
25 është lartësia detare dikun 1200 edhe duket një pjesë,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 53

1 domethënë duket Butovci, duket Lipjani, Obiliqi, Vushtria,
2 Podujeva.

3 Py. Do të thotë që është vend më i ngritur në kuotë se numri
4 2, kjo pika për të cilën --?

5 Pë. Po.

6 Py. Pra i bie të jetë telart, në ngjitje?

7 Pë. Po.

8 Py. Ju kuptoj.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një
10 moment. Shohim një shigjetë në hartë. Është e rëndësishme që
11 Dëshmitari të thotë se çfarë është kjo shigjeta?

12 Z. VON BONE: [Përkthim]:

13 Py. A mund të shpjegoni çfarë është kjo shigjeta?

14 Pë. Po e bëna këtë shigjetën me ja shpjegu avokatit nga kena
15 ecur. Dikun 150 metra në atë drejtim të shigjetës.

16 Py. Ju kuptoj.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit.

19 Z. VON BONE: [Përkthim]: Nuk e di a e kemi ruajtur këtë
20 fotografi apo jo, informacion. Sepse dëshiroj ta mbaj këtë
21 fotografi siç është, kështu me këto shënime dhe të kalojmë në
22 një fotografi tjetër.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Sekretare, është ruajtur? Jo. Është ende duke e bërë këtë
25 procedurë. Duhet të presim.

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është ruajtur.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Z. Avokat mund të vazhdoni.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë mirë që u ruajt.

6 Py. Tani dua të tregoj një fotografi me numër DSM00031.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

8 Sekretare, mund të plotësoni këtë kërkesë.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

10 Py. Z. Krasniqi e njihni këtë fotografi?

11 Pë. Po.

12 Py. Shoh një zotëri në këtë fotografi. Na thoni kush mund të
13 jetë ky?

14 Pë. Ky është Kadria, Kadri Krasniqi. Axha im, përndryshe
15 këtij i kam thënë babë.

16 Py. Faleminderit shumë. Pas tij shoh një ndërtesë. Më thoni
17 ju lutem çfarë është ajo ndërtesa?

18 Pë. Kjo është ajo ndërtesa ku vendosëm numrin 12, oda dhe një
19 dhomë tjetër. Është hambari po duket, dhe një pjesë e tij që
20 kanë lënë qumështin e këto.

21 Py. Dua që të jem shumë i saktë për këtë. Hambari, hambari ku
22 është? A është e mundshme që ta shënoni?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Avokat më duket se dëshmitar ka shënuar me këtë rrethin e
25 vogël të kuq.

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Ah e pashë, e pashë.

2 Py. Pra ky është hambari. A mund ta shënoni me numrin 2, ju
3 lutem. Shënoni 2, shkronjën 2.

4 Pë. [Shënon].

5 Py. Ndërtesa e mëparshme në fotografi ku po qëndron edhe
6 zotëria, mund ta shënoni me numrin 1, një 1.

7 Pë. [Shënon].

8 Py. Dhe në fund djathtas numër 2 shoh edhe një ndërtesë
9 tjetër. Po ajo çfarë është? Shënojeni me numrin 3 dhe na
10 shpjegoni çfarë është.

11 Pë. Kjo është ai, ata i kanë thënë çiler, domethënë kanë
12 lënë, qumështin, djathin, bulmetin me një fjalë.

13 Py. Po, në rregull.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe për të
15 qenë të plotë, z. Dëshmitar ndërtesa që e shënuat me numrin 1
16 mund të konfirmoni që është oda?

17 DËSHMITARI: Oda, po kjo është oda dhe një dhomë e fjetjes
18 ka qenë. E ka dritaren knejna.

19 Z. VON BONE: [Përkthim]: Dua që të shfaq një fotografi
20 tjetër, e nderuar Gjykatëse.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
22 të vazhdoni.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Është me numër DSM00028. Nëse
24 mund ta zmadhojmë, ju lutem.

25 Py. Z. Dëshmitar, më thoni ju lutem, çfarë shihni në këtë

1 fotografi? Dhe pastaj, dua që të më tregoni në të djathtë, ajo
2 që është para në të djathtë.

3 Pë. Këtë e ke shënu me numrin 5, kjo është ajo numri 10 që
4 tregova që ka qenë një objekt për ushqim të kafshëve.

5 Py. Më falni. Mbase ju kam keqkuptuar unë. Për cilën ndërtesë
6 e keni fjalën tani?

7 Pë. Numrin 5 që po duket kjo.

8 Py. E qartë. Mund ta përsëritni edhe një herë çfarë ishte?

9 Pë. Kjo ka qenë një vend ku kanë lënë ushqimin për kafshët.
10 Po duket këtu dera këtu ku është. Ka dy dyer, domethënë edhe
11 knejna në oborr edhe mbrapa oborrit.

12 Py. Në të djathtë të asaj ndërtesë shohim një tjetër
13 ndërtesë?

14 Pë. Po. Numri 4 e shpjegova edhe më herë, është një objekt ku
15 i kanë lanë pajisjet bujqësore.

16 Py. E keni fjalën për numrin 4 po besoni se është 4A.

17 Pë. Po. 4A.

18 Py. Dhe në të djathtë të ndërtesës të shënuar me 4A, çfarë
19 është ajo ndërtesa?

20 Pë. Kjo është ajo oda që diskutim ma herët, me një dhomë të
21 fjetjes dhe ka edhe një bodrum poshtë.

22 Py. Nëse përqendrohemi tek ndërtesa e odës. Më duket se në
23 mes të saj shoh një si derë. A e shihni edhe ju?

24 Pë. Këtu e ke fjalën?

25 Py. Po.

1 Pë. Po. Aty është.

2 Py. Ta zëmë se unë hy në atë derë, ku dal. Ku hy domethënë?

3 Pë. Djathtas a kanë dhomë e fjetjes. Majtas a kanë oda. Dhe
4 drejt ke mujt me dal jashtë oborrit, jashtë shtëpisë.

5 Domethënë korridor ka qenë.

6 Py. Kishte dalje, mund të hynin e të dilnin edhe nga ana
7 tjetër siç e kuptova?

8 Pë. Po.

9 Py. Thatë se -- kjo ishte e vetmja dhomë në atë ndertës, në
10 atë odë apo kishte ndërtesë tjetër. Se thatë që është
11 korridori?

12 Pë. Ana e djathtë.

13 Py. Në anën e djathtë ka dhomë, në anën e majtë ka dhomë. Po
14 në këtë ndërtesë ka ndonjë hapësirë tjetër, dhomë a, ku di
15 unë, vend tjetër?

16 Pë. Veç ky bodrumi që a kanë poshtë.

17 Py. Mund ta shënoni ju lutem atë bodrumin?

18 Pë. [Shënon].

19 Py. Për çfarë përdorej gjatë periudhës mars-prill 1999?

20 Pë. Ky gjatë marsit-prillit 1999 s'u përdor. Veçse nëse a
21 kanë tuj ra noj shi, ka pasë shumë njerëz, kena hi kena ndjet
22 deri kur është ndalë, ma shumë s'e kena përdor.

23 Py. Nëse hyn njeriu në atë bodrum ose hynte, sa i lartë do
24 ishte ky bodrum. Domethënë tavani, pak a shumë nëse e di? Pra
25 a mund të rrinte njeriu drejt, me trupin drejt apo duhej të

1 kërrusej?

2 Pë. Po. Ma merr mendja që po, unë jam i shkurtër.

3 Py. Ta themi me metra. Sa i gjerë mund të ishte nëse të
4 kujtohet, nëse mund të japësh një vlerësim kështu?

5 Pë. Ndoshta 3 me 4. Ndoshta ma i shkurtër. Mbase s'e kam
6 harru unë, s'e di.

7 Py. Kjo ndërtesa e odës, në prill të vitit 1999, për çfarë
8 përdorej, ndërtesa e odës?

9 Pë. Po, kena flejt aty, domethënë jo veç unë po Rrahman Dini
10 në realitet ka ndejt në odë këtu, janë kanë shtretërit.

11 Mandej me 20 prill, u bë si qendër spitali, mujn me thonë
12 atë. Kur i kena pastru të plagosurit prej Vitisë së Marecit.
13 Domethënë dy dhoma ka pasë.

14 Py. Në atë spital, kush punonte, në atë spital provizor, lloj
15 spitali, si me thnë.

16 Pë. Janë kanë Teuta, Ibadeti, ka pasë infermierë edhe të
17 tjerë që i kam njoft.

18 Py. I ke parë me sytë e tu ata njerëz kur ishin aty?

19 Pë. Të plagosurit?

20 Py. Të plagosurit por edhe këta që sapo përmendët, Teuta, e
21 të tjerë.

22 Pë. Po. Po, po i kam pa. Ka qenë Avnia, domethënë dy Avnia
23 janë kenë, Kadria. Janë kanë 17-18 me ja nis me t'i përmend me
24 emra. A ma shumë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 59

1 Avokat më falani që ju ndërpres. Po i afrohem orës 12. Kemi
2 një orë e gjysmë që bëjmë pyetje. Nëse gjeni një moment të
3 natyrshëm për të bërë pushimin, për të ndërprerë pyetjet, mund
4 të vazhdojmë pastaj mbas pushimit.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Kështu do të veprojmë.

6 Py. Personi që ju përmendët, Teuta, ja dini mbiemrin Teutës?

7 Pë. Nëse nuk gabojmë, Hadri, nëse nuk gabojmë.

8 Py. Folët edhe për një Avni.

9 Pë. Avnia ka qenë i plagosur, dy Avnia domethënë Avni Haziri
10 edhe Avni Gashi. Sokol Sopi, Afrim Vitia.

11 Py. Thatë që kishte të plagosur. Nga i sillnin këta të
12 plagosur?

13 Pë. Me datën 20 prill 1999, gjatë granatimeve në Viti,
14 domethënë disa ushtarë kanë vdekë e disa janë plagosur. Po jo
15 veç prej Vitisë së Marecit, por ka prur edhe prej Mramorit,
16 prej Prapashtice, prej pjesëve të tjera. Kur kena mbërri dikun
17 nga ora 12 e natës aty, ka kanë një tmerr. Domethënë në këto
18 dy dhomat. Lypshin ndihmë. Nuk kishin infermierët dhe mjekët
19 që janë kanë aty me dhënë ndihmë, s'kishte pasje të
20 mjaftueshme. Ibadetin që e ceka, atë e kam pas edhe në lagje
21 ku banojmë në Prishtinë. Atë e kam njoft edhe ma herët.

22 Py. Ju kuptoj. Si u shndërrua në spital, si ndodhi ky, pra si
23 u bë ky spital provizor.

24 Pë. Atë nuk e di unë, se domethënë prej datës 17 nuk kam qenë
25 aty, kam qenë në Viti të Marecit. Edhe dikun është dashur me i

1 lënë ata të plagosur. Nuk kena mujt me i lanë jashtë.

2 Py. Dhe ku i sillnin, i sillnin këtu?

3 Pë. Po. Ka pasë edhe në objektin tjetër, 100 për qind. Në 2,
4 3, 4, 5.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Dy minuta e nderuar Gjykatëse dhe
6 pastaj do bëj mbylljen e kësaj pjese.

7 Py. Kush ishte ai që mori vendim për ta kthyer në spital
8 provizor këtë? Kush e vendosi këtë, nëse e dini?

9 Pë. Thashë unë nuk e di se kam qenë në Viti, në datën 17,
10 domethënë tri ditë kemi qenë atje, nuk e di.

11 Py. Ju kuptova. Dhe e fundit, pamë në fotografinë e mëparshme
12 me të gjithë pamjen e kompleksit që i shënuat nga numri 1 deri
13 në fund. Kush ishte si të thuash i pari i atij vendi, kush i
14 merrte vendimet në atë vendndodhje

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nëse mundet një periudhë
16 kohore.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
18 duket se nuk është një pyetje e qartë edhe sikur po hymë në
19 një temë tjetër. Më mirë e bëjmë kështu, bëjmë një pushim tani
20 dhe pastaj vazhdojmë.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Pajtohem.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] shumë
23 mirë atëherë.

24 Z. Krasniqi tani do të bëjmë një pushim. Është pushim që
25 do të zgjasë një orë, pushimi i drekët. Do t'i kërkoj

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 61

1 Asistentes së sallës që t'ju shoqërojë dhe pastaj do të
2 shihemi bashkë në 13.05 minuta. Faleminderit shumë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
4 të shkoni bashkë me - të dilni nga salla.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 Atëherë tani do të bëjmë pushimin e drekës, një orë.

9 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
11 ka kërkesa tani?

12 Në rregull, shumë mirë. Shihemi sërish në orën 13.05.
13 Këtu ndërpritet seanca.

14 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.05

15 --- Seanca rifillon në orën 13.05

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 se erdhët. Të shohim kush janë të pranishëm. Janë të njëjtët
18 persona që ishin të pranishëm edhe sot në mëngjes. Kjo për
19 procesverbal. Mund të vazhdojmë atje ku e lamë përpara
20 pushimit. Do të kërkoj që të shoqërohet dëshmitari në sallën e
21 gjyqit.

22 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin.

23 Faleminderit.

24 Dhe pastaj do t'ia japim fjalën Avokatit të Mbrojtjes që
25 të vazhdojë me pyetjet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 62

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
3 se u kthyet, z. Krasniqi. Tani do të vazhdojmë me pyetjet e
4 Avokatit të Mbrojtjes, pra, do vazhdojmë me dëshminë tuaj.

5 Dhe më lejoni t'ia jap fjalën Avokatit në mënyrë që të
6 mund të vazhdojë me pyetjet e tjera për juve.

7 Fjala për ju, Avokat.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
9 Gjykatëse. Nuk e di sesa kohë kam ende në dispozicion.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kam
11 bërë këtë pyetje dhe në momentin kur të më thonë, do ju them
12 ekzaktësisht sesa kohë ka mbetur. Dhe do t'ju a them, pra,
13 sapo të më njoftojnë.

14 Z. VON BONE: [Përkthim]:

15 Py. Përshëndetje, z. Dëshmitar. Në ekran kemi ende
16 fotografinë. Nuk e di në qoftë se e keni akoma të treguar në
17 ekranin tuaj këtë fotografi?

18 Me të kuqe, pra, keni bërë shënimin tek dera dhe
19 gjithashtu keni bërë dhe një rreth në një pjesë tjetër të
20 këtij dokumenti.

21 Z. Dëshmitar, dua t'ju pyes, në periudhën -- pra, ju
22 thatë që u larguat nga Zllashi njëherë për të shkuar në
23 Prishtinë dhe që u kthyet prapë në Zllash. Nga ky moment e në
24 vazhdimësi, pra, nga ky moment që u kthyet në Zllash e më tej,
25 Zllashi ishte pak a shumë vendi ku ke qëndruar, ku ke fjetur

1 në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë të përhershme?

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

3 Dëshmitar, prisni pak ju lutem.

4 Z. Avokat, dua që ta bëni pak më precize, më specifike
5 pyetjen sa i takon datave. E mbaj mend çfarë tha, por nuk
6 është mjaftueshëm e qartë kjo për procesverbalin.

7 Dhe mund t'ju them që keni dhe 35 minuta në dispozicion.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë mirë.

9 Më duhet që të kontrolloj referencën për këtë për pyetjen
10 time, të nderuar Gjykatës.

11 Py. Por ju thatë që jeni larguar njëherë për të shkuar në
12 Prishtinë dhe pastaj në një pikë të caktuar u kthyet përsëri
13 në Zllash. A e kujtoni se në çfarë date ka ndodhur kjo?

14 E diskutuam më herët sot këtë gjë, po nuk e gjej dot
15 referencën për momentin.

16 Pë. Unë kam shku edhe disa herë të tjera në Prishtinë. Jam
17 kthy. Kam ndejtë një natë dy në Prishtinë, jam kthy. Po më
18 datën 27 mars, kam shku në Prishtinë kam ndejtë dy-tre ditë,
19 jam kthy. Mandej kam shku dikun me ka tretin, jam kthy prapë
20 qështu. Të 3 prill 1999.

21 Py. Por herën e parë kur u kthyet nga Prishtina, a do ishte e
22 drejtë të thuhej se --

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo pyetje
24 do të duhet të bëhet si pyetje e hapur. Sepse që në fillim,
25 duket sikur po shkon në një drejtim të caktuar.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ishit
2 pak më shpejt sesa qesh unë.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Më duhet të gjej referencën.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ju
5 jap kohë, po edhe unë po kërkoja për referencën për të
6 ndihmuar.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Le të gjej referencën së pari, se
8 në kundërtën do ngatërrohem. Vetëm një çast, ju lutem.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faqja
10 26. Dhe fillon diku, siç ma tregoi dhe kolegu im, tek rreshti
11 6 po vazhdon më tej. Dhe po ashtu në rreshtin 8 thotë
12 dëshmitari që: "Kam qëndruar aty deri më datë 30 ose më 1..."

13 Që ka qëndruar në Prishtinë.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
16 pastaj më poshtë shkojmë në faqen 27. Ju thoni në rreshtin 18:

17 "Që jeni larguar nga Prishtina dhe mbërritët në Zllash".

18 Thoni që:

19 "Keni mbërritur në orën 3.00 ose 4.00 të mëngjesit,
20 mëngjesin e datë 1".

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Do e marrë unë prej aty znj.

22 Gjykatëse. Shumë faleminderit.

23 Py. Z. Dëshmitar, po kërkoja një referencë. Më herët sot keni
24 thënë dhe këtë e keni thënë në faqen 27, rreshti 20, që:

25 "Unë mbërrita atje - dhe "atje" e keni fjalën për

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 65

1 Zllashin - pra, "Keni mbërritur në orën 3.00 apo 4.00 të
2 mëngjesit dhe në mos gabohem ka qenë data 1 prill".

3 Këtë keni thënë më herët sot.

4 Pyetja që kam unë është kjo, nga ai moment e më tej, a
5 keni qëndruar pak a shumë gjatë gjithë kohës në vendin e
6 familjes tuaj në Zllash --

7 Pë. Po, pak a shumë.

8 Py. -- në vendin që kemi diskutuar gjatë paradites sot?

9 Pë. Ma shumë kam qendru aty se jashtë.

10 Py. Shumë faleminderit.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duhet që
12 të shikojmë faqen 28 sepse duket sikur, në atë moment,
13 dëshmitari ka shkuar në Prishtinë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ma
15 more nga goja fjalën.

16 Z. Avokat, ai tha, që më pas, domethënë, pas herës së
17 parë është larguar prapë. Ka ikur prapë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. E thashë më përpara.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por
20 mënyrën sesi e kuptova unë -- ju lutem më lejoni që të mbarojë
21 pyetjen, sepse në të kundërtën nuk na dëgjojnë dot
22 përkthyesit.

23 Ajo çfarë kuptova unë ishte se pas herës së parë, ai ka
24 qëndruar deri më -- domethënë, u largua në një datë të
25 caktuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 66

1 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

2 Py. Pyetja mbetet e njëjta. Nga data 1 prill kur jeni kthyer,
3 keni qëndruar gjatë gjithë kohës në vendin që diskutuam sot?

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Avokat, dëshmitari sapo tha që nuk ka qëndruar gjatë gjithë
6 kohës atje. Ai na tha se është larguar për disa ditë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Po unë thashë "pak a shumë".

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
9 nuk bën kështu, nuk funksionon kështu. Ju lutem, jeni i saktë.
10 Mund të sugjerojë që të pyesni në qoftë se pas herës së dytë
11 ai ka qëndruar aty apo jo. Kjo mund të jetë një pyetje. Por
12 nuk duhet të merrni si pikënisje herën e parë që është kthyer,
13 sepse ne të gjithë e dimë që ai ka dhënë dëshminë dhe ne e
14 kemi dëgjuar dhe e ka thënë më përpara që është larguar dhe
15 herë të tjera.

16 Kështu që do të sugjeroja që pyetjen ta bëni në lidhje me
17 herën e dytë kur është kthyer.

18 A është në rregull kështu?

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, shumë mirë, znj. Gjykatëse.

20 Z. VON BONE: [Përkthim]

21 Py. Ti u largove nga aty edhe njëherë tjetër. Pyetja ime
22 është kjo: Kur u ktheve këtë herën e dytë, që është data 3
23 prill, keni qëndruar pak a shumë gjatë gjithë kohës në atë
24 vend? Domethënë gjatë ditës? Gjatë mbrëmjes? Apo keni lëvizur?

25 Pë. Më shumë kam qëndru aty.

1 Py. Në rregull. Në qoftë se do i hidhni një sy fotografisë që
2 keni përpara në ekran --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem, a mund t'i hiqni dëgjueset? Shumë faleminderit.

5 Z. Avokat, do të marrë referencën nga kolegu im i cili e
6 shkroi atë.

7 Në faqen 59, rreshti 8, dëshmitari thotë se ai u largua
8 më datë 3 prill nga Prishtina dhe u kthye. Por për ne, ose për
9 mua, nuk është e qartë se kur është kthyer.

10 Dhe tani ti po thua që ai është kthyer më datë 3. Por le
11 t'ia bëjmë këtë pyetje dëshmitarit.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Shumë faleminderit, e nderuar
13 Gjykatëse. Do ta bëj këtë pyetje. Por kisha përshtypjen që
14 dëshmitari i kishte dhënë përgjigje kësaj pyetje. Megjithatë
15 do t'ia bëj përsëri pyetjen dëshmitarit.

16 Py. Ju lutem mund të vini dëgjueset, z. Dëshmitar.

17 Z. Dëshmitar, në faqen 59, rreshti 8, ti the që je
18 larguar më datë 3 prill përsëri. A mund të na thoni se kur
19 jeni kthyer?

20 Pë. Qatë ditë jam kthye, domethënë, mbrenda 2-13 orëve jam
21 kthye prapë. Jam shku deri në Prishtinë dhe jam kthye.

22 Py. Shumë faleminderit. Nga ky moment e në vazhdim, kur jeni
23 kthyer nga Prishtina, a keni qëndruar pak a shumë gjatë gjithë
24 kohës atje në vendin të cilin e diskutuam sot paradite dhe që
25 pamë fotografitë?

1 Pë. Unë ju thashë edhe ma herët, që shumicën e kohës,
2 domethënë, e kam kaluar asajna. Domethënë, jam dalë deri në
3 fshat, jam shku në tjera fshatra që kam çu njerëz, se s'muj me
4 i thanë refugjatë se kanë qenë në vendin e vet. Po shumicën e
5 kohës jam kanë asajna.

6 Py. Në rregull. Keni fjetur aty?

7 Pë. Po, po.

8 Py. Shumë faleminderit. Tani do t'i kthehem përsëri
9 fotografisë që është në ekran. E shikoni fotografinë në ekran,
10 z. Dëshmitar?

11 Pë. Po.

12 Py. Në fotografi është një rreth i kuq që e keni vendosur në
13 ndërtesën në të djathtë.

14 Pë. Po.

15 Py. Pyetja ime është kjo: Do të thosha që njerëzit
16 pretendojnë që janë ndaluar në këtë ndërtesë, në këtë godinë.
17 Në qoftë se unë do jua thosha këtë gjë, çfarë reagimi do të
18 kishit ju?

19 Pë. Unë nuk di çfarë reagimi, po kurrë s'ka pasë në këtë
20 objekt njerëz të ndalum.

21 Py. Në rregull.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për procesverbal, të nderuar
23 Gjykatës. Ndjesë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
25 lutem a mund t'i hiqni dëgjueset, z. Dëshmitar? Faleminderit.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për procesverbal, të nderuar
2 Gjykatës, nuk mendoj që kjo është një fjali me vend, pra, që
3 njerëzit pretendojnë që kanë qenë të ndaluar në godinën që
4 është e shënjuar me rrethin e kuq. Thjesht e dua të shënohet
5 në procesverbal që nuk mendojmë që kjo është një deklaratë me
6 vend.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
8 lutem vazhdoni. Por mund ta bëni pyetjen, z. Avokat, në qoftë
9 se ai është në dijeni që njerëzit kanë qenë të ndaluar aty.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, do t'i bëj në vazhdimësi këto
11 pyetje.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vetëm
13 një sekondë, ju lutem. Sepse dua që së pari dëshmitari të
14 vendosë dëgjueset.

15 Z. Dëshmitar, vendosini dhe një herë dëgjueset.
16 Faleminderit.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] A keni parë ndonjëherë në qoftë
18 se në këtë godinë ose në çdo godinë tjetër në vendin që e kemi
19 diskutuar sot paradite, në qoftë se ka pasur të ndaluar
20 persona aty?

21 Pë. Jo, nuk kam pa. Këtë e them me bindje të plotë që nuk e
22 kam pa, as nuk ka pasë.

23 Py. Shumë faleminderit. A mund të kërkoj që të shfaqet
24 fotografia që kemi parë sot në mëngjes dhe kemi shënuar me të
25 gjitha shifrat dhe të gjitha shënimet e nevojshme. Dhe ju

1 lutem duam që këtë fotografi ta kemi si provë, pra, që të
2 ruhet me shënimet e bëra.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit, znj. Sekretare.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk jam i sigurtë se çfarë numri
6 i është dhënë fotografisë me të gjitha shënimet e bëra mbi të,
7 por dua që të shfaqet kjo fotografi në ekran. Po e kemi në
8 ekran tani. A mund ta zmadhoni, ju lutem.
9 Py. Z. Dëshmitar, në këtë fotografi keni shënuar ndërtesat që
10 shfaqen aty në këtë vend. A keni parë ju ndonjëherë në këtë
11 vend, në çdonjërin prej këtyre godinave të cilat ti i ke
12 shënuar me numra, në qoftë se ka pasur njerëz të ndaluar në
13 këtë vend?

14 Pë. Jo, nuk kam pa.

15 Py. Z. Dëshmitar, a keni dëgjuar ju ndonjëherë nga ndonjë
16 person në qoftë se ka pasur persona të ndaluar në këtë vend?

17 Pë. Jo, nuk kam dëgju.

18 Py. Z. Dëshmitar, Prokuroria ka një hartë që quhet "Kampi i
19 ndalimit në Zllash" ku shfaqet ky vend si një kamp ndalimi.
20 Çfarë reagimi ke ti për të? Çfarë mund të thuash ti për këtë
21 gjë?

22 Pë. Unë nuk muj me thanë -- nuk di ku i ka marrë Prokurori
23 ato informata, veç qetu në qet kompleks dhe në fshatin Zllash
24 kurrë nuk ka pasë qendër ndalimi.

25 Nuk di ka i ka marrë ato informata, kush ja ka dhanë.

1 Edhe, seriozisht, neve, si familje, shumë na ka bërë dëm kjo.
2 Py. Z. Dëshmitar, a keni parë ndonjë person që ka ruajtur, ka
3 qenë roje në një ndërtesë të caktuar në këtë vendndodhje?
4 Pë. E ceka dhe ma herët, që nuk ka pasë nevojë me u ruajt, a
5 kanë e haptme. Domethënë i ka pasë tri-katër hymje që ke mujt
6 me hi aty. Pasi që përreth fshatit ka pasë roje. Ka pasë te
7 Cërvadik, te Buna 29, ka pasë në Viti të Marecit, ka pasë në
8 Prapashticë, ka pasë në Keçekollë te Çelevit është një lagje,
9 ka pasë te Kurtevit është një lagje. Dhe s'kena pasë nevojë
10 për roje pasi u kanë në thellësi.

11 Çdo pikë i ka pasë diku 7-8 kilometra deri në 10.

12 Py. Në rregull. Z. Dëshmitar, kush ishte përgjegjës për këtë
13 vend në kohën kur ke qenë ti aty? A ka pasur ndonjë person që
14 vendoste në çfarëdo lloj mënyre se çfarë do bëhej me personat
15 që ishin të pranishëm aty apo ndonjë person që ishte si
16 komandanti i ushtarëve? A ekzistonte një person i tillë aty?

17 Pë. Po sa di unë Rrahmani ka qenë. Rrahman Dini, Bali, ka
18 qenë ai Isa Kastrati që kanë qenë pak ma të moshum, njerëz me
19 ma përvojë dhe ata atë që ka pasë diçka ata i kena pyetë dhe
20 ata na kanë thënë me shku.

21 Py. E kuptoj. Z. Dëshmitar, a e njihni një person me emrin
22 Fatmir Sopi?

23 Pë. Po e njoh. Dhe kam pasë fat me e njoftë atë njeri.

24 Py. A e keni parë ju atë në këtë vend?

25 Pë. Nuk më kujtohet këtë që e kam pa, po dikun nëse s'gaboju,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë private)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 72

1 në prill nja 3 kilometra, nja 2 kilometra larg tujit ka qenë
2 me komandantin Adem Shehu. E testojshin një armë diçka.
3 Atëherë i kam pa afër shpisë se jo te shpia.
4 Py. Në rregull.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua që të kalojmë në seancë
6 private, të nderuar Gjykatës.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të
8 na shpjegosh më pas arsyen pse.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
11 mirë.

12 Znj. Sekretare, ju lutem a mund të na kaloni në seancë
13 private ju lutem?

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë private)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 jemi rikthyer në seancë të hapur.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit shumë, znj. Sekretare.

5 Z. Avokat, mund të vazhdoni.

6 Z. VON BONE: [Përkthim]

7 Py. Z. Dëshmitar, a e njihni një person me emrin Sejdi
8 Veseli?

9 Pë. Po, e njoh.

10 Py. Nga e njihni?

11 Pë. Në vitin 1998 në tetor, ka mesi i tetorit, kam shkue me
12 një kojshi temin në Zllash edhe kena bisedu pak me të. Na i ka
13 dhanë dy çanta me gazeta, me "Çlirimin" dhe i kena çu në
14 Prishtinë dhe i kena shkep. Në prill të 1999 e kam takue në
15 lagjen Cubaj ka nejtë aty. Kanë nejtë edhe disa ushtarë tjerë
16 Valon Murati e shumë tjerë, që s'më kujtohen emrat e tyre.
17 Kështu i njoh krejt. Distanca pej shpisë tonë e ke ku ka nejtë
18 ai dikun është 270 metra, s'ka ma shumë.

19 Py. Ju kuptoj. Në fakt, pyetja ime kishte të bënte me këtë, a
20 ka ardhë edhe ai në këtë vend këtu?

21 Pë. Nuk e kam pa këtu.

22 Py. A e njihni një person me emrin Fatmir Humolli?

23 Pë. Po. Është fat i madh që e kam njoftë edhe atë.

24 Py. A e keni parë në këtë vendndodhje dhe atë?

25 Pë. Po. Dhe ai ka qenë këtu.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 75

1 Py. A dini gjë nëse ka qenë i martuar, nëse është i martuar?

2 Pë. Po. Është i martuar. Ka qenë tash --

3 Py. Thjesht për të qenë i sigurtë kur thoni që e patë aty, e
4 keni parë aty. Unë e kisha fjalën nëse e keni parë gjatë
5 periudhës mars-prill të vitit 1999, pra, e keni parë z.

6 Humolli aty gjatë kësaj periudhe?

7 Pë. Ndoshta edhe e kam pa. Edhe familjen, nëse s'gaboju, e ka
8 pasë aty një kohë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh
10 që z. Prokuror është ngritur në këmbë.

11 Z. Dëshmitar, hiqini dëgjueset ju lutem.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Duhet të përfundojnë këto lloj
13 pyetjesh sugjeruese që japin të gatshme përgjigjen. Sepse e
14 pyetën nëse gjatë kësaj periudhe e ka parë apo jo. Do të
15 kishte qenë më mirë se "kur e ka parë".

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jam
17 dakord. Jam dakord.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

19 Py. Z. Dëshmitar, a njihni një person me emrin Idajet Hyseni?

20 Pë. Nuk ndëgjova.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Përsëriteni pyetjen, ju lutem.

23 Z. VON BONE: [Përkthim]

24 Py. A njihni një person me emrin Hidajet Hyseni?

25 Pë. E kam takue më datën 1 prill, domethënë, kur jam largu

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Von Bone

Faqe 76

1 pej Prishtinës dhe ai ka qendru aty një natë, nëse s'gaboj.

2 Tash e di që mirret me politikë, është në një parti.

3 Py. Kur thua që "ka qëndru atje" çfarë doni të thoni?

4 Pë. Ka flejtë në shpiat tona.

5 Py. Ju kuptoj.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëpo ku?

8 DËSHMITARI: Saktësisht, po më kujtohet në numrin 3.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

10 keni fjalën në Zllash?

11 Pë. Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo në

13 Prishtinë?

14 Pë. Jo, jo. Në Zllash. Në Zllash. Kur kanë -- kur janë largu

15 pej Prishtinës dhe ai me popullatën doli atyna.

16 Z. VON BONE: [Përkthim]

17 Py. Z. Dëshmitar, më herët sot thatë në faqen 43 të

18 transkriptit dhe po përsëris këtu rreshta 17 dhe 18. Po

19 flisnim për këtë fotografi dhe citoj, po lexoj:

20 "Pas numrit 1, ka një rrugë që të çon në Prapashticë,

21 Keçekollë dhe Marec. Është rrugë kalimi".

22 Pë. Po.

23 Py. Z. Dëshmitar, afërsisht, nga kjo fotografi nga numri 1,

24 le të themi, duke u nisur nga numri 1, sa larg është afërsisht

25 ajo rruga për të cilën po flisnit këtu?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Ç'doni të thoni "sa larg është rruga"?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] E kam fjalën për distancën. Sa
4 është distanca midis rrugës nga pika 1?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
6 atëherë sa është distanca pika 1 aty ku fillon rruga?

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Aty ku ndodhet rruga?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

9 Z. VON BONE: [Përkthim]

10 Py. Z. Dëshmitar, e keni të qartë pyetjen?

11 Pë. Po, po. E kam të qartë pyetjen. Domethënë pi numrit 1
12 dikund 200 metra është rruga që shkon për Prapashticë, Marec,
13 Keçekollë e katunde tjera. Po edhe kjo numri 10 ku është, ose
14 9, ose 8, shifet një rrugë edhe kjo të çon në qatë drejtim.
15 Këtu, para se me shku te numri 10, është një rrugë që të çon
16 në fshatrat e Krelevë e Kamenicë në ato pjesë të anës
17 Gjilanit.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
19 Avokat, dua t'ju rikujtoj se sipas dy orëve të përcaktuara,
20 ato mbarojnë në orën 2 pa një çerek. Domethënë, dy orët që
21 keni vlerësuar mbarojnë në orën 2 pa një çerek.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

23 Py. Z. Dëshmitar, dëshiroj t'i tregoj dëshmitarit një pjesë
24 të deklaratës që na ka dhënë me numër DSM00014.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Avokat, para se të vazhdoni.

2 Z. Dëshmitar, hiqini dëgjueset.

3 Z. Avokat, mos doni që ta konfrontoni me diçka që ka
4 thënë tani, e cila ndryshon nga ajo që ka thënë në deklaratën
5 e mëparshme?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Ndryshon. Tha diçka më herët sot
7 për një datë të caktuar dhe ndoshta këtu në deklaratë është
8 dhe data, por janë edhe dy data që vijnë para asaj date.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
10 doni t'i rifreskoni kujtesën?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a
13 ja keni bërë pyetjen?

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të sigurohem që ajo që ka
15 thënë në atë që ka thënë faqen 56, në rreshtat 14, 15 kur
16 thotë "nuk e di se isha në Viti për tre ditë nga data 17
17 prill"

18 Në deklaratën tonë thotë:

19 "Më duket se ka qenë rreth datës 15, 16 a 17 prill a
20 rreth kësaj kohe, sepse nuk mund ta mbaj mend me saktësi
21 datën, kur u zgjuam në orën 5.00 të mëngjesit dhe na thanë të
22 shkojmë në Viti të Marecit rreth 4 kilometra nga vendndodhja e
23 shtëpisë".

24 Ky është konteksti.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Dëshmitar, vendosini sërish dëgjueset. Faleminderit.

2 Znj. Sekretare, mund të vazhdoni.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. E shohim në paragrafin e dytë, tre-katër rreshtat e
5 fundit.

6 Z. Dëshmitar, sot paradite, i dhatë përgjigje një
7 pyetjeje dhe në atë përgjigje thatë:

8 "Thashë që nuk e di sepse kam qenë në Viti tre ditë duke
9 fillu nga data 17 prill".

10 Në deklaratën të cilën na e keni dhënë neve, si Mbrojtje,
11 si ekip i Mbrojtjes, më datë 23 shkurt, thatë dhe po të doni
12 mund ta lexoj është nga paragrafi i dytë, por është dhe
13 përkthimi ngjitur me të.

14 Po e citoj, po e lexoj siç është këtu:

15 "Mendoj se ishte rreth 15, 16 ose 17 prillit, ose rreth
16 asaj kohe, sepse nuk po mund të më kujtohet saktësisht data,
17 kur na zgjuan në 5.00 të mëngjesit dhe na u tha, na thanë pra,
18 të shkojmë në Viti të Marecit diku rreth 4 kilometra nga
19 vendndodhja e shtëpisë".

20 Dhe "shtëpi" është shtëpia në Zllash për të dhënë
21 kontekstin e plotë.

22 Sot paradite në mënyrë konkrete përmendët datën 17. Dua
23 t'ju pyes, a jeni i sigurtë për këtë datë konkrete që dhatë
24 sot? Sepse në deklaratë këtu keni thënë ishte rreth 15, 16 apo
25 17 prillit.

1 Na e sqaroni, ju lutem?

2 Py. Po dhe në fillim ju kam thënë që me data pak jam keq.

3 Nuk i di. Nuk i mbaj mend fort, por po më 17, po më kujtohet,
4 që ka fillu lufta në Viti të Marecit dhe kena shku më 17. Dhe
5 kjo data e 17 prillit është e saktë. Deri më 20 prill.

6 Py. Që do të thotë se do të ishte e saktë nëse do të thoshim
7 që në momentin kur ja keni dhënë deklaratën Mbrojtjes nuk keni
8 qenë i sigurtë për datën dhe sot jeni i sigurtë?

9 Pë. Po, sot jam i sigurtë.

10 Py. Po si ka mundësi që sot jeni i sigurtë. Domethënë mos ka
11 diçka që ju erdhi në mendje?

12 Pë. Nuk ka diçka po tuj udhëtu për Hagë, i pashë portalet, i
13 pashë lajmet që shokët e tonë kanë shku kanë bë homazhe tek
14 varrezat e dëshmorëve atje, në Viti të Marecit, familjarët dhe
15 më kujtohet ajo tash.

16 Py. Ju kuptoj. Z. Dëshmitar, --

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pas pak do
18 ta përfundoj.

19 Py. Sot folëm shumë për këtë vendndodhjen në Zllash, në këtë
20 vend. Ju treguam fotografi. Na treguat duke e përshkruar atë
21 vend. A e keni parë ndonjëherë në atë vend Salih Mustafën?

22 Pë. Po e kam pa. Dhe kam pasë fat që e kam taku.

23 Py. Ç'periudhë, sa gjatë ka qëndruar ai aty, ka qenë ai aty?

24 Pë. Salih Mustafa më së shumti ka qendru dy ditë, tre ditë e
25 ka lëvizë. Domethënë nëse s'gabo, në dhjetor e kam taku ma së

1 pari, para vitit të ri. Me një grup a ardhë. Dhe ata djemtë
2 tani kanë shku për Majac në luftë se atje ka pasë luftë në
3 vendin tonë s'ka pasë, a kanë ma qetë. Ka ardhë në janar ka
4 nejtë një ditë dy, ka shku. Nuk a kanë detyrë e jemja ka a
5 shkue apo me e pyetë. U sjellë mirë me ne.

6 Py. Në periudhën mars-prill 1999, a e keni parë ndonjëherë
7 atë aty në atë vend në Zllash për të cilin folëm sot, pra,
8 shpiat e familjes?

9 Pë. Po, po. U kanë para ofensivë, nëse s'gaboj, ka nejt veç
10 një natë edhe ma deri në 21 prill nuk e kam pa. Më 21 prill, e
11 kam taku, jo unë po krejt shokët që jena kanë me të plagosun e
12 kena takue te Çelevit dikun në mbrëmje ka qenë edhe deri në
13 Koliq kena shku bashkë. Në Koliq, ne kena vazhdu për Majac me
14 të plagosun. Aty jena nda.

15 Py. A të kujtohet sa herë gjatë muajit prill ka qenë ai aty
16 në prill të vitit 1999?

17 Pë. Thashë më herët, që disa ditë para ofensivës ka qenë, ka
18 ndejtë një natë dhe ka vazhdu. Po nuk e di bash datën e saktë,
19 se unë në data aso, e nuk e di ka ka shkue. Ka pasë punë tjera
20 sigurisht.

21 Py. Mund të na thuash përse erdhi aty që bënte çfarë?

22 Pë. Jo, ato nuk janë kanë punë të miat me vet atë pse je
23 ardhë aty.

24 Py. Po ku qëndronte në cilën?

25 Pë. Dhoma numër 2.

1 Py. Në cilën shtëpi a dhomë?

2 Pë. Në dhoma numër 2. Aty a kanë një televizor. Aty ka
3 ndejtë.

4 Py. Po funksiononte?

5 Pë. Jo, s'ka pasë rrymë veç. E kena pasë aty pajisje.

6 Py. Prandaj e bëra dhe këtë pyetje.

7 E fundit, e shoqëronte dikush që e njeh?

8 Pë. E kam njof një Cufa a kanë, po emrin nuk ja di. Që ka
9 ardhë disa herë me të, por nuk ja di emrin nuk ja di. Emrin
10 nuk ja di. Nuk po më kujtohet. Edhe se kam vet qysh e ke
11 emrin. S'ka bë me e vet qysh e ke emrin.

12 Py. Z. Dëshmitar, a ke dëgju ndonjëherë nga njerëz që ishin
13 aty në atë ku po qëndroje dhe ti, nëse ndonjëherë Salih
14 Mustafa ka maltratu ndokënd aty?

15 Pë. Jo, nuk kam ndëgju, as e kam pa.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Një minutë, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Patjetër.

19 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Një pyetje.

21 Py. Z. Dëshmitar, folëm sot më herët për z. Rrahman Dini. A
22 të ka bërë ndonjëherë pyetje ai për diçka?

23 Pë. Po. A kanë 6 ose 7 prilli. Helikopteri me Kryqin e Kuq i
24 forcave serbe na ka vëzhgu disa herë, kena tentu me e gju.

25 Edhe u dalë pej numrit 12 është një dritare aty edhe më ka

1 thënë "Hajde mbrena". Jam shku mbrena. Më tha "Nuk bën me gju
2 Kryqin e Kuq". Thashë "Po ata po na vëzhgojnë". Tha "S'ka
3 lidhje" tha "ai është helikopter i Kryqit të Kuq edhe na nuk
4 bën me bë kësi gabimesh".

5 Py. Në rregull.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi më pyetje të tjera, të
7 nderuar Gjykatës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit, z. Avokat.

10 Kam unë një pyetje për sqarim, z. Dëshmitar. E bëhet
11 fjalë për faqen 77, rreshtat 7 dhe 8. Avokati i Mbrojtjes po
12 ju pyeste nëse z. Mustafa ishte apo e kishit parë aty në këtë
13 vend që po diskutojmë dhe në rreshtin 6, ai ju pyeti: "A e
14 shoqëronte dikush që ti e njeh?"

15 Dhe ju u përgjigjët: "Po, njoha Cufën..."

16 Ju pastaj thoni: "Cufa vinte me të", ma merr mendja me z.
17 Mustafën, "disa herë", pra, "erdhi disa herë me të". Pyetja
18 ime është: Kur ishin këto herë?

19 DËSHMITARI: Po në janar, shkurt ka ardhë, mars. Po e
20 thashë edhe ma herët që nuk ka ndejtë një natë dy, e treta s'e
21 ka zënë aty kurrë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sa
23 shpesh ka ndodhur kjo në janar, shkurt dhe mars që z. Mustafa
24 vinte bashkë me këtë Cufën?

25 DËSHMITARI: Po ndoshta në janar a kanë dy herë, krejt

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Çështje procedurale

Faqe 84

1 janarin dy herë. Se unë nuk kam mbajtur shënime. S'kam pasë
2 nevojë me mbajtur shënime sa herë kush po vjen kush po shkon.
3 S'jam kanë i obligim. Me sa më kujtohet.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase
5 nuk jam as shumë e qartë. Po ju bëj një pyetje nuk po ju marr
6 në provim pra.

7 Sa herë ju pyeta në janar. Ju thatë dy herë. Po në
8 shkurt, edhe nëse nuk e dini mund të thoni dhe nuk e di.

9 DËSHMITARI: Po ndoshta -- nuk muj me caktu me numra sa
10 herë ka qenë.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
12 dua numrin e saktë, po mbase njëherë në javë, dy herë në javë.

13 DËSHMITARI: Ndoshta një herë në dy javë ka qenë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
15 në mars?

16 DËSHMITARI: Në mars a kanë, ka nejtë para ofensivës.
17 Domethënë nuk e di datën edhe ka shku dika mo tani deri më
18 datën 21, dikun rreth orës 20.00 ose mbrëmjes se me orë s'muj
19 me e cekë e kena takue në fshatin Keçekollë te Çelevitë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
21 flisni për marsin?

22 DËSHMITARI: Po, më 21 mars. Atë se harroj kurrë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Faleminderit. Mjafton hë për hë.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Edhe një shtesë, e nderuar

1 Gjykatëse. Nëse e kuptova përgjigjen mirë, kjo nuk është se
2 ishte në Zllash apo në Keçekollë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
4 kuptova. A mund të flisni më me zë më të lartë sepse ishte i
5 fikur mikrofoni apo nuk e kishit për procesverbalin këtë që
6 thatë.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Po thashë që në fjalinë e fundit
8 nuk foli për Zllashin po për një zonë tjetër.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
10 këtë the.

11 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani do të pyes Zyrën e
12 Prokurorit të Specializuar.

13 Z. Prokuror, mund të bëjmë tani një gjysëm ore pushim dhe
14 pastaj mund të bëni ju një përgatitje të fundit për pyetjet,
15 kundrapyetjet ose mund të fillojmë menjëherë. E keni ju në
16 dorë.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne jemi
18 gati për të filluar. Po dëshiroj që të printoj diçka, mbase
19 për këtë duhet të bëj pushimin.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Atëherë do të bëjmë pushimin tani dhe pastaj do të vazhdojmë
22 një orë e gjysëm pas pushimit.

23 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërohëni dëshmitarin
24 të dalë nga salla.

25 Z. Dëshmitar, do të bëjmë tani një pushim gjysëm ore.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Çështje procedurale

Faqe 86

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
3 mirë. Do të shihemi pas 30 minutash.

4 Këtu ndërpritet seanca.

5 --- Pauza fillon në orën 13.56

6 --- Seanca rifillon në orën 14.26

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vërej
8 se ekipet kanë të njëjtën përbërje.

9 Znj. Asistente e Sallës, ju lutem shoqëroni dëshmitarin
10 të hyjë në sallë.

11 Propozoj kështu, të bëjmë një seancë një orë e gjysmë, të
12 bëjmë dhe një pushim 30 minuta dhe pastaj të bëjmë dhe një orë
13 tjetër dhe të shohim se ku jemi me dëshminë e dëshmitarit.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
16 se u rikthyet z. Krasniqi. Më dëgjoni?

17 DËSHMITARI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
19 mirë. Atëherë do të vijojmë kështu. Do të bëjmë tani një
20 seancë një orë e gjysmë pas së cilës një pushim prej gjysmë
21 ore dhe pas të cilit edhe një orë tjetër dhe me aq do ta
22 mbyllim për sot.

23 Në rregull.

24 Do t'ia jap fjalën tani Zyrës së Prokurorit të
25 Specializuar që t'ju bëjnë ata pyetje.

1 Z. Prokuror, keni fjalën.

2 Pyetje të palës tjetër z. De Minicis:

3 Py. Mirëdita z. Krasniqi.

4 Pë. Mirëdita.

5 Py. Do t'ju bëj disa pyetje në emër të ZPS-së. Përpiquni që
6 të përgjigjeni në mënyrë sa më koncize, të përqendruar pra,
7 pyetjeve të mia.

8 Z. Krasniqi, gjatë intervistës së parë me ekipin e
9 Mbrojtjes më datë 23 shkurt të vitit 2021, keni bërë, keni
10 punuar pra me një skicë të vizatuar në dorë të kompleksit të
11 shtëpive të familjes. Ju kujtohet?

12 Pë. Po.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse
14 mundet, numri DSM00017 ta paraqesim në ekran.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ma
16 merr mendja se e keni fjalën që është numri i skicës ky?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, je shumë e saktë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
19 rregull.

20 Znj. Sekretare, ju lutem ta plotësoni kërkesën.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ta bëjmë që të duket i gjithë
22 skeçi - më falni skica, ju kërkoj ndjesë.

23 Py. Z. Krasniqi, a është nënshkrimi i juaj ai në të majtë
24 poshtë të skicës?

25 Pë. Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 88

1 Py. Sipas asaj që keni shkruar në deklaratën e datës 23
2 shkurt 2021 -

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe të nderuar Gjykatës e kam
4 fjalën për dokumentin numër DSM00004.

5 Py. Avokati i Mbrojtjes e ka përpiluar këtë skicë gjatë
6 vizitës në kompleksin e shtëpive të familjes. Ju vetë a e keni
7 shoqëruar Avokatin e Mbrojtjes në atë vizitë që ka bërë në
8 vend?

9 Pë. Po.

10 Py. Sipas vulës kohore të gjetur në deklaratë, intervista ka
11 zgjatur nga ora 10.00 deri në orën 6.05 të pasdites.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe këto gjenden në faqen, pra
13 në fajlin DSM00001 dhe DSM00015.

14 Py. Pastaj keni diskutuar edhe për ndërtesat në këtë skicë
15 rreth orës 11.35 minuta të paradites.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Që duket në faqen DSM00004.

17 Py. Pastaj bëtë pushimin për drekën dhe pastaj vijuat që të
18 diskutoni për ndërtesat që janë të paraqitura në skicë mbas
19 dreke. Është kështu? Ju kujtohet kjo z. Krasniqi?

20 Pë. Po, më kujtohet, po këtu e kena bo një gabim në skicë.

21 Py. Në rregull. Do të arrijmë aty. Thjesht desha t'ju pyes a
22 ju kujtohet që ishte kjo koha pak a shumë që keni filluar të
23 punoni për këtë?

24 Pë. Po.

25 Py. Tani keni bërë një intervistë të dytë me Mbrojtjen më

1 datë 19 prill të vitit 2021. Gjëja e parë që jeni regjistruar
2 se keni thënë në intervistë është kjo, në hartën e mëparshme
3 që keni bërë aty ka disa gabime të vogla. Kur e kuptuat që i
4 kishit bërë ato gabime z. Krasniqi?

5 Pë. E kom kuptue kur jam taku me avokatin. Pasi që ka qenë
6 edhe pandemia, jam konë edhe pak i smut, e kom pasë dhe
7 familjen smut edhe që ajo ka qenë krejt që e kom ba atë gabim.
8 Se unë ja kom dhonë fotografitë që i keni pasë këtu, avokatit.

9 Py. Në rregull. Pra ju e kuptuat këtë ndërmjet intervistave
10 nga intervista e parë deri tek e dyta, pra përpara sesa të
11 shkonit të takoheshit me Avokatin e kuptuat se kishit bërë
12 gabim?

13 Pë. E kuptova që kom bo gabim edhe e përmirësum këtë gabim.

14 Py. Pra ishte ti që i thatë Avokatit Mbrojtës që ka pasë një
15 gabim në skicën e parë jo e kundërta? Ti i the Avokatit jo
16 Avokati ty, kështu?

17 Pë. Ma merr mendja që edhe unë i kom thonë Avokatit, s'e di,
18 s'më kujtohet.

19 Py. Nuk e mbani mend? A mund të ketë ndodhur që të ketë thënë
20 Avokati ty?

21 Pë. Nuk e di, nuk më kujtohet edhe nuk ka pasë ça me mshef
22 këtu se e kom harru veç një pjesë.

23 Py. Jo, jo z. Krasniqi, nuk po flas se po fshihni ndonjë gjë
24 këtu, por thjesht po them që në fillim të intervistës së dytë
25 ke përmendur që ka disa gabime të vogla. Pra thjesht po vrisja

1 mendjen që si e kuptova domethënë nga njëra intervistë tek
2 tjetra që kishte gabime?

3 Pë. E kam pa këtë skicën dhe ai më ka kujtu që kam bo do
4 gabime. Ato gabime s'janë konë shumë gabime të mëdhaja.

5 Py. Këtë e kuptuat kur patë skicën apo ndërmjet dy
6 intervistave, nga intervista e parë deri tek e dyta që kishit
7 bërë gabim?

8 Pë. Ndoshta gjatë vizatimit e kom kuptue, s'po di. S'po më
9 kujtohet.

10 Py. Ndoshta. Nuk e mbani mend hë?

11 Pë. S'pat shumë rëndësi për mu ky gabim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

13 Prokuror, sa për mua, për ta kuptuar. Mos shihni në atë
14 drejtim, më shikoni mua.

15 Z. Dëshmitar, mesa duket ju e keni kuptuar që keni bërë
16 një gabim. A mund t'i thoni Trupit Gjykses - sepse në fund të
17 fundit nuk është se duhet t'i tregoni Mbrojtjes ose
18 Prokurorit, por duhet të na thuash neve, duhet të na tregosh
19 neve se edhe ne duhet që të kuptojmë, sepse në fund fare ne
20 jemi ata që e marrim vendimin.

21 A mund të na e shpjegosh të lutem se kur e kuptove - i
22 the vetes "uuu nuk është ekzaktësisht kështu siç ka qenë
23 situata". Kur e kuptove këtë gjë?

24 DËSHMITARI: Ndoshta edhe mbas intervistës që kom pasë me
25 Avokatin mu ka kujtu që e kom bo një gabim. Edhe kur jam taku

1 herën e dytë që data s'më kujtohet cila datë ka qenë, e kena
2 përmirësu këtë gabim. Domethënë nuk është gabim i madh që e
3 kena bo, por gabon njeri, mundet me gabu. Nuk mundet me tu
4 kujtue gjithçka, pasi që edhe unë nuk kom lind aty. Unë kom
5 lind në Prishtinë edhe ku mujt edhe me harru një detaj, shumë
6 i vogël ka qenë.

7 Ne nuk jemi këtu për të thënë se kush kishte të drejtë
8 ose kush e kishte gabim, për të thënë në qoftë se gabimi ishte
9 i vogël apo i madh, thjesht dua që të kuptoj faktet, të dëgjoj
10 faktet.

11 Ajo çfarë kuptoj unë tani është që ti po na thua që e
12 dhatë dëshminë e parë, domethënë po bëj një përmbledhje, e
13 dhatë dëshminë e parë dhe pas dëshmisë së parë e menduat dhe
14 njëherë dhe pastaj kuptuat që ka diçka që nuk ishte dhënë e
15 plotë. Dhe tani e kuptoj plotësisht. Kjo ndodhi?

16 Tani më lejoni t'ia jap fjalën dhe njëherë z. Prokuror që
17 të vazhdojë me pyetjet. E keni ju fjalën z. Prokuror.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

19 Py. Ju bëtë një gabim të vogël, por për të qenë e qartë se i
20 thatë Mbrojtjes se keni bërë disa gabime të vogla - e keni
21 thënë në shumës - disa gabime të vogla. Keni bërë më shumë
22 sesa një gabim z. Krasniqi?

23 Pë. Jo, s'kom bo më shumë se një gabim. Edhe kjo dera këtu te
24 numri 5, domethënë unë q'atë derë e kom gabue.

25 Py. Pra një gabim kishit bërë apo më shumë sesa një gabim?

1 Pë. Mes numrit 4 edhe 5 ka qenë edhe një objekt.

2 Py. Po, ekzaktësisht. Sepse në fakt i vetmi gabim që unë
3 shikoj që keni korigjuar në deklaratën e mëpasshme është që
4 ti ke harruar një ndërtesë të tërë të papërmendur në
5 intervistën e parë apo jo?

6 Pë. Nuk është një ndërtesë e tërë po u konë një, një depo.

7 Py. Do ta shohim. Do të arrijmë në këtë pikë. Por keni lënë
8 pa përmendur një ndërtesë ose një dhomë të tërë dhe ky ishte
9 gabimi juaj i vogël, kështu është?

10 Pë. Për mu është, po.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Ju lutem, a mund të shfaqet
12 në ekran atë çfarë Mbrojtja e ka quajtur "Harta" DSM00035.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
14 lutem vazhdoni me shfaqjen e hartës, znj. Sekretare.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 Py. Z. Krasniqi, cila është ndërtesa që përfaqëson gabimin e
17 vogël? 4B është?

18 Ju lutem mund të shikoni në hartë besoj një ndërtesë që
19 ka 4A. A është ky gabimi i vogël që keni bërë dhe që nuk e
20 keni përmendur në intervistën e parë?

21 Pë. Po.

22 Py. A keni bërë gabime të tjera?

23 Pë. Po.

24 Py. Çfarë gabimesh të tjera? Çfarë gabimesh korigjuat në
25 intervistën e dytë?

1 Pë. A muj?

2 Py. Patjetër.

3 Pë. Edhe këtu nuk e di a e ka harrue avokati apo unë që s'e
4 kom bo edhe këtë objektin që duket këtu. Ose ma nalt tash kjo
5 është tjetër skicë.

6 Py. Në rregull. Z. Krasniqi, a të ka thënë ty ndonjëherë
7 ndonjë person që ndërtesa 4A, ndërtesa që e harruat që ta
8 përfshinit gjatë intervistimit të parë me Mbrojtjen është
9 vendi ku ZPS-ja pretendon që njerëzit janë ndaluar dhe janë
10 torturuar.

11 Pë. Jo, nuk më ka thonë kurrkush. Ma së pari e kam ndi në
12 televizion domethënë prej juve.

13 Py. A çuditeni që e mësoni që është pikërisht kjo ndërtesa që
14 keni harruar juve ta përfshini në fillim?

15 Pë. Jo, nuk çuditna unë se vetëm e kam harru. E kam harru
16 edhe këtë këtu. Po e sheh ku e nënvizova.

17 Py. Pra ju nuk e kishit idenë se çfarë rëndësie kishte kjo
18 ndërtesë, pra ndërtesa 4A kur harruat që ta përmendni
19 ekzistencën e saj gjatë intervistës së parë?

20 Pë. Jo nuk e kam pasë as idenë çfarë rëndësie ka për juve si
21 Prokuror se për mu s'ka pasë rëndësi kurrëgjja kjo. S'kanë pasë
22 rëndësi as këta bunarat që janë, veç i kena vizatu.

23 Py. E kuptoj. Po ju pyes sepse në intervistën e parë duket
24 sikur keni kaluar goxha kohë lidhur me anën A të kësaj skice.

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju lutem të nderuar Gjykatës

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 94

1 nuk e di në qoftë se mund të kalojmë në një hartë të mëparshme
2 që identifikohet me numrin DSM00017.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 lutem vazhdoni, znj. Sekretare.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Duket sikur dëshmitari
6 ka bërë një shënim në hartën që kemi përpara. A ta ruaj me
7 ndryshimet e bëra nga dëshmitari?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
9 Faleminderit znj. Sekretare, që na kujtuat. Ju lutem ruajeni
10 me shënimet e bëra nga dëshmitari.

11 Faleminderit. Tani mund të vazhdojmë.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me dokumentin DSM00017.

13 Faleminderit.

14 Py. Siç po thoja, z. Krasniqi, ju duket sikur keni shpenzuar
15 goxha kohë për të punuar me këtë hartë së bashku me Avokatin e
16 Mbrojtjes dhe e keni ndihmuar Avokatin që të bëjë disa
17 korrigjime.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, i
19 referohem këtu materialit me numër identifikimi DSM00005. Për
20 shembull ju thatë që një hapësirë për kashtë, për ruajtjen e
21 kashtës nuk është përfshirë në këtë skicë? Është kështu?

22 Pë. Jo, nuk e thashë ashtu. Thashë mes numrit 5 edhe 4 ka
23 qenë një objekt ku i kena lënë mjetet bujqësore. Dhe numri 5
24 ka qenë për kashtë dhe për ushqim.

25 Py. Po, këtë doja të thoja dhe unë. Kjo nuk ishte e

1 reflektuar ne hartë fillimisht. Dhe e solle në vëmendjen e
2 Mbrojtjes në mënyrë që të sqarohej kjo në hartën tjetër apo
3 jo? E ngritët edhe këtë si çështje? Po apo jo?

4 Pe. S'e kuptova pyetjen.

5 Py. Ju kërkoj ndjesë. Ju thatë që ana 1 është pak a shumë e
6 plotë. Pra unë mund të bie dakord me anën A dhe kam shtuar
7 gjithashtu edhe objektin 5 dhe kam dhënë gjithashtu edhe
8 gjatësinë.

9 Dhe keni shtuar dhe gjatësinë prej 12 metrash aty. Kështu
10 është?

11 Pë. Po.

12 Py. Me anë të shigjetës e keni thënë këtë. Dhe Mbrojtja e ka
13 hequr këtë, e ka fshirë këtë dhe mbështetur në atë çfarë ju
14 kujtohet ju e keni bërë këtë shtesë edhe pastaj është bërë
15 korrigjimi tek harta që është përpara, a është kështu?

16 Pë. Po.

17 Py. Dhe pasi është shtuar ndërtesa 5, ju thoni që ana A e
18 skicës është e saktë apo jo?

19 Pë. Jo, jo. E thashë edhe ma herët. Gabimin ku e kom bo
20 domethënë është mes 4-shit dhe 5-shit në skicën e parë. Në
21 skicën e dytë e kena përmirësue. Numri 5 ka ekzistue.

22 Py. E kuptoj, e kuptoj këtë. Por në atë kohë, më 23 shkurt
23 2021, ju ishit të kënaqur. Ju i thatë Avokatit që ana A tani
24 është e plotë pasi kishit shtuar ndërtesën 5. Nuk ia keni
25 thënë ju këtë apo ia keni thënë?

1 Pë. Ndoshta edhe ia kom thonë.

2 Py. Ka të bëjë me deklaratën tuaj. A thoni që ajo çfarë
3 reflektohet në deklaratën tuaj është një reflektim i saktë i
4 asaj çfarë i keni thënë Avokatit në atë kohë?

5 Pë. E saktë është. Unë të thashë që mbasi që kena pa gabimet,
6 i kena përmirësue.

7 Py. Në intervistën e dytë jo në të parën apo jo?

8 Pë. Po.

9 Py. Në rregull. Pas kësaj keni vazhduar që të përshkruani
10 disa dhoma të tjera në anën B. Domethënë më pas ju bëtë një
11 pushim dhe pastaj pas pushimit ju keni dhënë detaje të tjera,
12 detaje të cilat kanë të bëjë me të dyja anët në këtë skicë, në
13 anën B dhe ne anën B [sipas përkthimit]. A është e saktë kjo?
14 Domethënë juve kaluat dhe njëherë të dyja anët e skicës dhe
15 prapë nuk ju kujtohet ndërtesa 4A gjatë këtij procesi apo jo?

16 Pë. Të thashë nuk mu ka kujtue edhe kam harru ndoshta aq
17 shumë.

18 Py. E kuptoj, e kuptoj, e kuptoj çfarë thatë. Po në atë kohë
19 nuk ju kujtua. Domethënë kaluat orë të tëra për të diskutuar
20 për hartën por nuk ju kujtua që ekzistonte ajo ndërtesë. A
21 jemi dakord që nuk ia thatë Avokatit këtë ndërtesë herën e
22 parë? Po apo jo?

23 Pë. Nuk i kom thonë. Me i pas thonë e kishim vizatue.

24 Py. E kuptoj. Z. Krasniqi, gjatë intervistës së parë me
25 Avokatin Mbrojtës, juve e latë pa përmendur këtë ndërtesë,

1 sepse ju e dinit që në këtë ndërtesë ishin torturuar dhe ishin
2 ndaluar persona dhe dëshironit që të ndihmonit z. Mustafa.
3 Keni shpenzuar orë të tëra për të bërë hartën. Ti nuk është se
4 harrove një pemë. Por harrove një ndërtesë të tillë, të tërë.
5 E bëtë qëllimisht këtë gjë?

6 Pë. Jo, nuk e bona qëllimisht po e kam harru. Të thashë edhe
7 njëherë e kam harrue edhe nuk e kam bo qëllimisht edhe nuk ka
8 pasë asi tortura në atë pjesë.

9 Py. Në rregull. Z. Krasniqi, pasi u përballët me fotografitë
10 e ndërtesës që mungonte, Avokati Mbrojtës ju pyeti se çfarë
11 lloji ndërtese ishte ajo ndërtesë dhe ju pyet Avokati, çfarë
12 ndërtese ishte 4A-ja?

13 Dhe ju përgjigjeni më pas.

14 "Ishte e pamundur që të qëndroje atje dhe që të ishte e
15 banueshme."

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe kjo jepet në intervistën e
17 dytë në numrin, në dokumentin e identifikuar si DSM00020.

18 Py. A ju kujtohet që ia keni thënë këtë gjë Avokatit
19 Mbrojtës?

20 Pë. Po ia kam thonë edhe 10-shi edhe 4-shi janë konë të
21 pabanueshme. E thashë edhe ma herët në intervistë.

22 Py. Në këtë rast ju i referoheni ndërtesës 4A. Avokati ju
23 pyet çfarë lloji ndërtese ishte kjo dhe ajo çfarë thua ti në
24 përgjigje të pyetjes ishte që ishte një ndërtesë që ishte e
25 pamundur ku të jetoje dhe që ishte një ndërtesë që përdorej

1 për të ruajtur si magazinë për të ruajtur gjërat.

2 Pë. Po.

3 Py. Më pastaj Avokati ju pyet: "Gjatë luftës në periudhën nga
4 janari 1999 deri në fund të luftës kjo godinë, kjo ndërtesë
5 nuk përdorej?"

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në të njëjtën faqe.

7 Py. Sërish ju bëhet një pyetje e përgjithshme, për referencë
8 të përgjithshme në qoftë se përdorej apo jo kjo godinë. Dhe ju
9 thoni që:

10 "Nuk përdorej fare sepse ishte një ambient i pabanueshëm.
11 Njerëzit nuk mund të qëndronin në të."

12 A e mbani mend që e keni dhënë këtë informacion në mënyrë
13 vullnetare?

14 Pë. Po, e mbaj mend. Kom thonë se u konë e pabanushme. Ti ke
15 mujt me hi nëse ka ra shi. Ke mujt me hi mrena q'aty, po jo ma
16 shumë.

17 Py. Ju i keni thënë Avokatit që ajo ndërtesë nuk është
18 përdorur fare. Sot na thoni që ajo ishte hapësirë për të
19 mbajtur pajisjet bujqësore.

20 Z. DE MINICIS: Të nderuar Gjykatës, do t'ju jap
21 referencën më pak, pas pak kohësh.

22 Py. Domethënë si është çështja? Kjo godinë, kjo ndërtesë nuk
23 është përdorur fare, fare apo është përdorur vetëm thjesht për
24 të mbajtur pajisje bujqësore?

25 Pë. Po deri në vitet '90, unë që ashtu e kom spjegu që aty

1 kanë lonë pajisjet bujqësore ça kanë pasë të asaj kohe.

2 Py. Po nuk i keni thënë të njëjtën gjë Avokatit të Mbrojtjes
3 në deklaratën tuaj. Nuk i keni përmendur fare pajisjet
4 bujqësore në atë kohë. Dhe ju deklaruat -

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Edhe kjo jepet në DSM00020 për
6 ju të nderuar Gjykatës.

7 Py. "Që përpara vitit 1990, ndërtesa është përdorur për
8 stallë". Domethënë për çfarë përdorej? Përdorej për pajisje
9 bujqësore apo përdorej për bagëtitë sepse duket sikur i ke
10 thënë tjetër gjë Avokatit Mbrojtës dhe tjetër gjë po i thua
11 Trupit Gjykues sot.

12 Pë. Unë të thashë, ma së pari kom lind në Prishtinë, jam rrit
13 në Prishtinë. Me sa e di, sa më ka thonë familja aty ka pasë -
14 për mjete bujqësore.

15 Py. Po Mbrojtjes pse i keni thënë tjetër gjë?

16 Pë. Ndoshta edhe kam gabue. Po s'besoj që kam gabu se unë
17 këtu, për këtu para vitit '90 kam fol me fjalë të familjes
18 domethënë ça më kanë thonë, kjo ka shërby për q'atë, kjo për
19 q'atë, kjo për q'atë. Unë e ceka edhe ma herët unë kam lind në
20 Prishtinë, jam rrit në Prishtinë. Jam shku në pushim tre muj
21 të verës me familje.

22 Py. Pra nuk e dinit në qoftë se ishin bagëti apo në qoftë se
23 ishin mjete bujqësore, vetëm thjesht me hamendësim e thatë.

24 Pë. Kur e kena prish këtë ndërtesë krejt para 4 vjete - 5,
25 domethënë aty ka pasë vllaça nuk e di qysh i thojnë, domethënë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 100

1 pjesë të bujqësisë ka pasë mrena. Bile edhe sot ekziston një
2 pjesë aty e maqinës afër numrit 1.

3 Py. E kuptoj. Avokati ju pyeti - po flasim për të njëjtën
4 dhomë. Ai ju pyeti:

5 "A ke parë njerëz në prill të vitit 1999 që qëndronin në
6 këtë ndërtesë dhe ti ke qenë i pranishëm aty?"

7 Përgjigjja është:

8 "Jo. Mbase dikush mund të shkuar për ta parë brenda, por
9 ishte tërësisht e shkatërruar brenda."

10 Çfarë ke dash të thuash me këtë?

11 Pë. S'e kuptova. Dhe njëherë pyetjen nëse ka mundësi pak më
12 shkurt.

13 Py. Patjetër, z. Krasniqi. Ju i keni thënë Avokatit të
14 Mbrojtjes, që brenda ndërtesës 4A, brenda, përbrenda ndërtesës
15 ishte "tërësisht e prishur, e shkatërruar." Këto janë fjalët
16 që ke thënë ti siç janë regjistruar në deklaratën që i keni
17 dhënë ju Avokatit të Mbrojtjes.

18 Çfarë donit të thonit me këtë? Dhe e kam fjalën për këtë
19 shprehjen "ishte tërësisht e shkatërruar nga brenda."

20 Pë. U konë e pabanushme. S'po di qysh me ta spjegue. U konë e
21 shkatërrume. U konë problem me nejt aty. Ja kam spjegu edhe
22 Avokatit që 3-shi, 4-shi, 7-shi, 8-shi, 9-shi kanë qenë shpia
23 me llaç, me gurë.

24 Py. E kuptoj. Pra në atë kohë çatia kishte i rënë, kulmi
25 kishte rënë? Thjesht doja, domethënë dua që të kuptoj

1 domethënë se pse kishte grumbull mbetjesh aty në mes.

2 Pë. Pjesërisht u konë e shkatërrume. Domethënë ka pikë edhe
3 shiu aty në pjesë-pjesë. Tjegullat janë konë të dëmtume.

4 Py. Po e kemi dëgjuar që ishte e lagësht.

5 Po muret a ishin shkatërruar, kishin rënë?

6 Pë. Edhe muret janë konë pjesë-pjesë të lagëta domethënë.

7 Py. Po ky pingu i mbetjeve domethënë çfarë ishte se po
8 mundohem që të kuptoj që çfarë i ka penguar njerëzit që të
9 qëndrojnë aty?

10 Pë. Po të tregova që ajo ka shpi ka qenë me llaç, me baltë e
11 mbarume.

12 Py. Nuk i jep përgjigje pyetjes time. Domethënë ky pingu i
13 mbetjeve që ishte aty, çfarë ishte?

14 Pë. Po mundohena me ta spjegua edhe njëherë. Ajo pjesë
15 domethënë 3-4 dhe ajo pjesa që s'e kena cekë në këtë hartën e
16 parë, 7-shi, 8-shikojmë kanë qenë të mbarume me llaç.

17 Py. Unë e kam fjalën për ndërtesën - E vlerësoj shumë
18 përpjekjen tuaj për të na shpjeguar situatën, por po i
19 referohem ndërtesës 4A. Po flas për këtë ndërtesë. Ju lutem të
20 përqendrohemi këtu tek kjo ndërtesë.

21 Pë. Ndërtesa 4A ka qenë e mbarume me llaç. Llaçin nuk e di
22 qysh me ta spjegua. Me kashtë edhe me llaç. Ndoshta ka ndonjë
23 përkthyes që ta spjegon ma mirë.

24 Py. E njoh në fakt edhe kashtë edhe llaçin. Nuk është
25 problem, e kuptoj këtë. Po mund të vazhdojmë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 102

1 Pë. Se të hin ujtë, ajo domethënë s'ka jetë. Pasi që prej
2 vitit 1990, nuk ka intervenu kurrkush edhe kaq.

3 Py. E kuptoj. Ajo çfarë doni të thoni është që nuk jeton dot
4 rehat, domethënë as ju as familja jua nuk do jetonte aty. Për
5 këtë e ke fjalën?

6 Pë. Po aty s'kena jetue. Ta spjegova që ajo s'ka qenë për me
7 jetu.

8 Py. Nuk ishte një vend shumë i rehatshëm për të qëndruar
9 njerëzit apo jo?

10 Pë. E spjegova edhe ma herët. Nuk u konë ajo për njerëz aty.
11 Ajo u konë për pajisje për me lënë diçka aty, jo njerëz.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
13 Prokuror, sa i takon referencës që të mos ta harrojmë.

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faqja 38.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
16 Unë kam tjetër faqe por jua lë juve në dorë.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Më falni se nxitova. Ndërkohë
18 kolegja ka gjetur dhe faktikisht pajisjet bujqësore janë
19 përmendur në faqen 3, rreshti 19.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
21 rregull. Këtë e kishim për procesverbalin. Ne e vumë re që
22 ishte në faqen 52, rreshtat 14 deri në 17.

23 "Numri 4 siç shpjegova më herët ishte vendi ku mbaheshin
24 pajisje bujqësore."

25 "Thoni fjalën, numrin 4. Apo e keni fjalën për 4A?"

1 Përgjigje:

2 "Po, 4A."

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
4 Gjykatës, është përmendur dy herë.

5 Kërkoj që të paraqitet tani dokumenti me numër DSM00028 -
6 në ekran është një fotografi. DSM00028

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
8 të vazhdoni.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

10 Py. Është ndërtesa 4A për të cilën po flisni apo jo?

11 Pë. Po.

12 Py. Dhe besoj se biem dakord, pajtohemi që aty duket që çatia
13 dhe muret janë në vend. Mund të jenë prishur më mbrapa. Dhe
14 kjo fotografi është bërë në vitin 2006.

15 Pë. Muret ti a po e shef ku është, qysh janë konë të dëmtume
16 edhe para 2006-s edhe para '99-s.

17 Py. Po e shikoj që është në gjendje të dobët. Po edhe një
18 mundësi të fundit nëse mund të na thoni. Na thatë që është
19 bërë me llaç dhe kashtë. Po desha që Trupit Gjykses, t'i
20 shpjegoni Trupit Gjykses dhe ç'është ky parg, ky parg
21 mbeturinash. Ky parg ku nuk mund të qëndronin njerëzit.

22 Ç'ishte kjo?

23 Pë. Nuk thashë "mbeturina" se mbeturinat janë diçka tjetër,
24 kur i merr i shtin mrena. Po thashë prej ujit kjo u demolu.

25 Unë q'ashtu e kuptoj.

1 Py. E kuptoj, e kuptoj këtë që thoni tani. Po biem - pra i
2 keni thënë kështu Mbrojtjes se aty s'keni përmendur që aty ka
3 hy uji? Në fakt sot -

4 Pë. A ka hy uji a jo, nëse më kishte vetë i kisha thonë. Po
5 nëse s'më ka vetë s'i kam thonë.

6 Py. Në fakt keni të drejtë se Mbrojtja ju ka pyetur:

7 "A keni parë ndonjëherë njerëz në '99-n që të kenë
8 qëndruar në këtë ndërtesë?"

9 Keni thënë:

10 "Jo, se mbase mund të shikoje brenda, por ishte krejt
11 rrënojë, krejt e shkatërrime brenda."

12 Këtë po përpiqem të kuptoj. Edhe duke e parë fotografinë
13 dhe mbase mund të na e shpjegoni.

14 Pë. Unë e thashë edhe njëherë, po e përsëris edhe s'kam
15 nevojë ma shumë me e përsërit. Kjo u konë e pabanushme edhe
16 këtu njerëzit s'kanë banu kurrë, as në vitet '90-ta, as '80-
17 ta, as 70-ta.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

19 Prokuror.

20 Z. Dëshmitar, jo, ju. Më shpjegoni sepse kemi dhjetë
21 minuta që merremi me këtë rrënojë, shkatërrim, pirg. Ç'është
22 ky pirg, rrënojë, pirg, shkatërrimi? Mund të na e shpjegoni.
23 Dhe e keni fjalën që është thjesht llaç, pirg llaçi, pirg
24 gurësh, dru. Se unë s'kam qenë aty. Duhet të na e shpjegoni ju
25 neve, nëse mundeni sigurisht të na e përshkruani sepse këto

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 105

1 fjalë keni përdorur. Nuk i kemi përdorur ne këto.

2 DËSHMITARI: E nderume Gjykatëse, unë po e spjegoj edhe
3 njëherë nëse kuptohemi tash drejtë. Ky objekt, sipas familjes,
4 deri në vitet '90-të ka qenë për mjete bujqësore, domethënë
5 ata ç'a më kanë thonë. Edhe në vitet '90-ta pasi familja janë
6 dalë në Prishtinë krejt, domethënë edhe axha, kjo ka fillu të
7 rrënohet, të prishet. Tjegullat e vjetra edhe i ka hi uji
8 mrena. Q'ato jam ka mundohena me spjegu. Nuk ka marrë kurrkush
9 mbeturina me shti mrena aty. Po u kanë prej llaçit, prej
10 shiut, prej borës u kanë e pabanushme me një fjalë. Edhe këtu
11 banorë s'ka pasë kurrë as të familjes tonë, as të tjerë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Mendoj se na e sqaruat. Mendoj se na e sqaruat. Faleminderit.
14 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.
16 Py. Do të qëndrojmë edhe më gjatë në këtë faqe me numër
17 DSC00020 [sipas përkthimit] se pas saj ndërtesë, pra për
18 ndërtesën 4A, Avokati i Mbrojtjes ju ka pyetur dhe për
19 ndërtesën numër 5. Dhe aty thatë që ishte për të mbajtur
20 kashtë ose bar të thatë.

21 Avokati i Mbrojtjes ju ka pyetur a është përdorur kjo
22 ndërtesë gjatë periudhës së luftës?

23 Dhe ju i thatë se kur erdhën refugjatët prej Zllashit
24 është përdorur sepse nuk kishte hapësirë për të gjithë,
25 hapësirë të mjaftueshme pra. Dhe e keni përmendur edhe këtë

1 kasolle ose ndërtesë për bar të thatë apo kashtë. Keni thënë
2 se është përdorur ndërtesa 5 për të strehuar refugjatët që
3 kanë ardhur në Zllash.

4 Pë. Po, e kanë përdorë se kanë qenë diku mbi 100 qytetarë
5 aty. Ndoshta dhe më shumë.

6 Py. Po dhe në fakt ju keni thënë që: "Kur njerëzit janë largu
7 nga Prishtina, kanë ardhë prej Prishtine kemi përdorur çdo
8 vend të mundshëm se s'kishte vend të mjaftueshëm për të
9 fjetë."

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Është në faqen DSM00023, në
11 deklaratën e dytë.

12 Py. Ju kujtohet që keni thënë kështu që përpiqeshe të gjenit
13 hapësirë kudo ku kishte vend?

14 Pë. Po kjo është e vërtetë që kom thonë.

15 Py. Dhe thatë që ndërtesa 5 është përdorë edhe pse ishte
16 shumë ftohtë me fjetë aty. Po ma merr mendja për shkak të
17 rrethanave nuk është se ju kushtoi shumë rëndësi a ishte shumë
18 rehat a jo. Mjafton që të futeshit brenda. A ju kujtohet që e
19 keni thënë edhe këtë? Është në deklaratën tuaj, DSM00020.

20 Pë. Dëgjomë, këtu qëllimi u konë me bo një vend mos me të lag
21 shiu, bora se ajo kohë ka qenë edhe me borë edhe me shi. Janë
22 nerdh pak a s'nerdh, ato s'janë konë fort, s'kanë çu fort
23 peshë. Se kjo edhe duket qysh është e hapme.

24 Py. Po e shoh që është e hapur. Po shoh që është prej druri a
25 prej, prej degësh e bëme diçka ashtu është. Prapë unë jam pak

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 107

1 i hutuar se ju thatë që në godinën 4A, askush s'ka nejt se
2 s'kishte muret siç duhet pra dhe nuk - po, më falni - nuk
3 duket se është më e mire pra apo më keq se 5-a. Po tek 5-a
4 kanë ndenjur njerëz, ama tek 4A nuk kanë ndejt askush. A nuk
5 keni thënë kështu?

6 Pë. Unë të thashë që kur e kena rrënu këtu këtë objekt
7 komplet ka pasë mjete bujqësore ala aty. Ka pasë vllaça. Nuk e
8 di qysh i thojnë - nuk muj me spjegue. Ka pasë shumë mjete
9 bujqësore. Edhe u konë llaç aty.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
11 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjes. Nuk ka rëndësi. Nuk
12 dua të dëgjoj për prishjen e ndërtesave. Dua, pra u bë pyetja
13 pse njerëzit janë strehu në ndërtesën 5 po jo në ndërtesën 4A?
14 Se këtu jemi. Nuk jemi tek prishja.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

16 Py. Ju thatë se njerëzit mund të flinin kudo ku kishte vend.
17 Dhe megjithatë ju thatë që ndërtesa 4A s'është përdorur kurrë
18 sepse në prill të vitit '99-të është përdorur si burg apo jo?

19 Pë. Jo s'e thashë si burg. Ti po e thu atë.

20 Py. Unë po e them. Unë po e them dhe po ju pyes. Po ju them
21 është përdorur si burg dhe e dinit shumë mirë.

22 Pë. Në fshatin Zllash edhe përkatësisht në këtë shtëpi këtu
23 kurrë s'ka pasë burg. Askush s'ka mujt me thonë që ka pasë
24 burg.

25 Py. Ju që keni qëndruar në atë kompleks dhe e dini shumë mirë

1 që atje janë mbajtur njerëz të ndaluar dhe kjo është arsyeja
2 përse ju keni punuar me këtë hartë me orë të tëra. Edhe pse u
3 morët me orë të tëra prapë nuk përfshitë këtë ndërtesë në
4 hartë. A nuk është kjo e vërteta?

5 Pë. Se unë s'kisha mujt me e përfshi, e pse tani e përfshiva
6 pastaj disa ditëve?

7 Py. Nuk e di. Do ta shpjegoni ju këtë.

8 Pë. Unë të spjegova edhe njëherë. I kena harru do detale
9 shumë të vogla edhe i kena qitë masanejna prapë.

10 Py. Po kjo hollësi e vogël është kjo ndërtesa 4A, që është
11 një ndërtesë e plotë.

12 Pë. Ti nuk ke përjetu ça kena përjetu na, se e kishe harru
13 edhe emnin tand. Ça kam hjek unë, ça kam përjetu unë, familja
14 jem, gjithë Zllashi, gjithë populli i Kosovës, kanjëherë thom
15 qysh po e di edhe emnin tem. Me tu vra njerëzit ma të mirë, me
16 tu vra anëtarët e shpisë edhe me i majt krejt këto në mend
17 është shumë vështirë, besoni Trupi Gjykues. Grunë e axhës, 65-
18 vjeç ma kanë plagosë edhe ka vdekë në Francë prej plagëve të
19 Serbëve. Më kanë vdekë shokë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk i
21 vë në dyshim këto që po thoni. Thjesht mos e merrni personale.
22 Mos e bëni personale. Po të dëgjojmë dëshminë tuaj. Por ju
23 kuptoj. Ju kuptoj shumë mirë ato që ju thoni.

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

25 Py. Z. Krasniqi, kam respektin, kam respekt maksimal për atë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 109

1 çka keni heqë asaj kohe, por i keni dhënë shumë detaje, shumë
2 hollësi, shumë hollësi në intervistën e parë Avokatit të
3 Mbrojtjes, dhoma të vogla, dhoma më të vogla se ç'kishte aty
4 brenda, kush ishte strehuar aty. Ndërkohë që këtë e keni
5 harruar, një ndërtesë të tërë e keni ndërtuar [sipas
6 përkthimit]. Dhe unë po ju them e keni harruar nuk e keni
7 përmendur sepse e dinit shumë mirë, e dinit shumë mirë se ky
8 ishte vendi ku njerëz shqiptarë të Kosovës janë mbajtur të
9 ndaluar në Zllash në vitin '99-të?

10 Pë. Po, veç në atë shtëpi. Historikisht edhe në '99-n edhe
11 kurrë s'ka pasë njerëz të arrestum ose të ndalum në këtë
12 shtëpi. Edhe kom cek edhe në deklaratë e nderume Gjykatëse se
13 për dëshmi të rrejshme e di çfarë pasojash kam. E kam edhe në
14 deklaratë të Avokatit. Edhe deri në vdekje nuk muj me pranë se
15 s'ka pasë në atë shtëpi as njerëz aty që po pretendon
16 Prokurori i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Atëherë po vazhdojmë më tutje
18 të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
20 mund të vazhdoni.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

22 Py. Z. Krasniqi, në intervistën e parë i keni thënë
23 Mbrojtjes, por edhe sot i thatë se ju kujtohet se disa njerëz
24 edhe ju vetë ishit një prej tyre ju janë bërë pyetje në
25 kompleksin e shtëpive. Kjo ka ndodhur pas sulmeve të NATO-s. A

1 është kështu?

2 Pë. Po, veç kom kërkue edhe kur e kam pa deklaratën sqaroj se
3 aty kam desh me thonë bisedë jo pyetje. Këta e kanë bo pyetje.

4 Py. Thatë se 3 a 4 njerëz u janë bërë pyetje në atë që
5 përmendni në dhomën 4?

6 Pë. Nëse thom "pyetje" domethënë jam konë edhe unë aty. Por
7 nuk po thom pyetje po janë hi për bisedë. Një ndër ta e kam
8 takue edhe një njeri, u konë rreth 50-ve, me një jakne të
9 ushtrisë, bile nëse s'gaboje e kam cek ushtar. E kom lonë tu
10 pritë aty edhe po bisedoj me të e tha "Po iki deri te Rrahman
11 Dini." Kam shku deri te shkolla në Zllash e cila i ka dikund 1
12 kilometër prej shpijave. Ka jam kthy e kam takue në rrugë atë
13 njeri. I thashë, "Ka po shkon?" Tha, "Kjeshë te Rrahman Dini,
14 po nuk ka armë." Ai kish ardhë për me u bo ushtar i Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës. S'ka pasë armë edhe ka shku në drejtim
16 të vetit.

17 Kanë ardhë shumë asi njerëz, janë konë të interesum me ju
18 bashku Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kanë bisedu me
19 Rrahmanin, s'ka pasë armë e kanë vazhdu rrugëve të veta. E
20 tash se Avokati më ka vetë çfarë ndikimi ka pasë Rrahman Dini,
21 nëse s'gaboje ose çfarë pozite. Unë i kom thonë Avokatit që aty
22 e kom kuptu që e ka një pozitë se më ka thonë edhe mund, "Mos
23 boni gabime. Mos e gjuni helikopterin. Boni ksi. Jemi një
24 ushtri e re. Nuk guxojna na me bo gabime.". Që kaq e kam cek
25 aty.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 111

1 Py. Dhe kjo ndodhi pas bombardimeve të NATO-s, pas sulmeve të
2 NATO-s?

3 Pë. Po, pas, diku më datën 1 ose 2 kanë ardhë shumë qytetarë
4 prej Prishtinës. Flitet që në Gollak janë konë mbi 100 mijë
5 banorë të ndjekun prej Prishtinës.

6 Py. Pra ju ishit i kyçur në UÇK prej shtatorit të '98-s dhe
7 ju thatë që vetë Rrahman Dini i kërkoi familjes tuaj të
8 përdorte shtëpiat dhe vetëm në atë moment e kuptuat që Rrahman
9 Dini duhej të kishte ndonjë farë influence. Se kështu po
10 dëshmoni sot. Nuk kishit asnjë ide, nuk e dinit fare që
11 Rrahman Dini kishte ndonjë influencë?

12 Pë. Rrahman Dinin e ka njoftë familja edhe ma herët, e kom
13 njoftë edhe unë po shumë pak. Po familja e ka njoftë ma mirë.
14 Edhe në bazë të miqësisë, në bazë të shoqnisë Rrahmani ka
15 kërku me u taku me babën edhe me axhallarët.

16 Py. Dhe thatë që ishit i pranishëm edhe atë ditë apo jo?

17 Pë. Qeshë tu e spjegu po ndërhyne.

18 Edhe dikund në gusht, në mes të gushtit ose para
19 shtatorit, jena shku tek shpijat, e kena taku Rrahman Dinin
20 edhe ai ka ardhë e ka kërku shpinë por jo për vete personal po
21 e ka kërku për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Edhe prindi jem
22 edhe axhallarët kanë pranë edhe janë konë shumë të lumtur që
23 një ditë që shpija jonë me u bo shtabi i Ushtrisë Çlirimtare
24 të Kosovës.

25 Py. Faleminderit z. Krasniqi, do të arrijmë edhe aty. Në këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 112

1 fotografi gjëja e fundit që do ju kërkoj të bëni është që të
2 rrethoni me stilolapsin që keni përdorur vendin ku pikësëpari
3 - vendi ku ju kanë bërë pyetje juve dhe të tjerëve, a është i
4 dukshëm në këtë fotografi?

5 Pë. Është i dukshëm po unë po kërkoj prej Gjykatës jo pyetje
6 po të bëjmë bisedë se pyetje është -

7 Py. Absolutisht. Mirë vendi ku keni bërë bisedë a është i
8 dukshëm në këtë fotografi dhe nëse po rrethojeni me rreth.

9 Pë. Këtu e ka hymjen.

10 Py. Pra ishte lart. A e dini që kishte edhe - a nuk tha që
11 ka edhe një dhomë nën të me një hyrje tjetër, pra poshtë
12 dhomës që ju rrethuat? Pra zbret si të thuash teposhtë dhe
13 është si një kat më poshtë, poshtë dhomës që ju rrethuat. A
14 nuk është edhe aty një dhomë.

15 Pë. Asht, nuk asht dhomë, po asht një farë bodrumi.

16 Py. Bodrum. Në rregull. Faleminderit shumë.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
18 vazhdoj. Nuk e di nëse e nderuara Gjykatëse kërkon ndonjë
19 sqarim lidhur me këtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Thjesht një pyetje se s'jam krejt e sigurt nëse kuptova diçka
22 shumë mirë.

23 Kur thatë lidhur me, thatë diçka - pra kur thatë që, "I
24 kërkesë Trupit Gjykses që të mos bëjë pyetje por të bëjë
25 bisedë me mua." Përse e keni fjalën?

1 DËSHMITARI: Në deklaratë është e shkruar. Aty e kanë bo
2 gabim.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
4 rregull, në rregull.

5 DËSHMITARI: Veç fjala "pyetje" le të bohet "bisedë",
6 fjalia domethënë që ajo fjali se po e ndryshon kuptimin tani.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,
8 është e qartë, është e qartë. Është e qartë.

9 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

11 Py. Z. Krasniqi, a keni qenë ju anëtar i njësisë BIA?

12 Pë. Ma vonë, po.

13 Py. Kur u bëtë anëtar i njësisë BIA?

14 Pë. Po, më 17 e di që - 17 prill që kam shku me ushtarë të
15 njësisë BIA, kam shku në Viti, në fshatin Marec. Edhe prej
16 atyjit jam mbetë me ta.

17 Py. Në rregull. Por në UÇK kishit prej shtatorit të vitit '98
18 apo jo?

19 Pë. Bash prej shtatorit jo, ma vonë pak jam shku. Prej
20 shtatorit kom fillu me iu ndihmue.

21 Py. Për shembull në shkurt dhe mars të vitit '99, në cilën
22 njësi të UÇK-së bënit pjesë?

23 Pë. Unë kom shku edhe në Prishtinë, domethënë edhe në atë
24 kohë kom shku në Prishtinë, kam marrë armatim, kam marrë
25 pajisje.

1 Py. Jo, po ju pyes, në cilën njësi bënit pjesë? Ishit anëtar
2 i cilës njësi?

3 Pë. Domethënë në dokumenta më shkrujn që në shkurt jam anëtar
4 i BIA-s.

5 Py. Prej shkurtit? Pra jo prej - pra prej shkurtit të vitit
6 '99?

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
8 nuk e di a e lexoj mirë këtu që këtu thotë me letra, me letra.
9 Se sugjeroj që të sqarojmë se çfarë do të thotë
10 dëshmitari me këtë "me dokumenta".

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

12 Py. Çfarë, për çfarë dokumentesh e keni fjalën?

13 Pë. Që jemi të regjistruar si veteran i Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës.

15 Py. Po përse ky dokument thotë që jeni të regjistruar në
16 shkurt, ndërkohë që ju jeni anëtarësuar në BIA vetëm më datë
17 17 prill, pra jo më herët?

18 Pë. Po nuk e kanë ditë domethënë këta e kanë pa që unë jam
19 konë aty prej nëntorit të '98-s edhe e kanë marrë që atë datë,
20 s'po di. Në realitet unë që në atë kohë ku janë bo këto jam
21 konë smut mbas lufte domethënë. S'kam pasë mundësi as me shku
22 me apliku, i ka mbushë tjetërkush.

23 Py. Ju kuptova. Po në fakt, a keni qenë anëtar i BIA-s në
24 shkurt të vitit '99-të siç thuhet me dokumente?

25 Pë. Ndoshta dhe kam qenë. Unë kam shku në Prishtinë kam taku

1 shumë djem. Nuk po muj se - dëgjomë Prokuror.

2 Py. Mos po i thoni Gjykatësve se nuk e dinit që ishit a nuk
3 ishit asokohe? Sepse këtë thatë, këtë sapo thatë z. Krasniqi,
4 "Mbase dhe kam qenë."

5 Py. Ja që ta spjegoj ma qartë.

6 Aty në atë vend nuk i ka interesu kurrkujna a është me
7 njësinë BIA, a është me Karadakun, a është me Brigadën 153.
8 Qëllimi u konë me u konë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës. Nuk ka pasë ndasi.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
11 prapë nuk është përgjigje ndaj pyetjes. Po se kishte rëndësi
12 kë kishit epror apo jo. Duhet të ishte e rëndësishme se kush
13 ishte shefi si me thënë. Nga dikushi i merrnit urdhrat. Por po
14 ia lë Prokurorit. Po për mua vetë unë nuk e kuptoj përgjigjen.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jam i sigurt që Gjykatësit s'e
16 kuptojnë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
18 nuk e kuptoj, nuk e kuptoj fare përgjigjen tuaj sepse ju e
19 dini shumë qartë që nga data - pra e ditkeni shumë mirë nga
20 data 17 prill jeni që u bëtë anëtar i BIA-s me letra, me
21 dokumenti u regjistruat mbas lufte se keni qenë anëtar i BIA-s
22 duke filluar nga shkurti.

23 Dhe pastaj pyetja iu bë, "A keni qenë apo jo anëtar i
24 BIA-s në shkurt?"

25 Dhe ju thoni, "Mbase edhe kam qenë."

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 116

1 Por mjafton të thoni - jo - dhe do jua them qartë, duhet
2 të përgjigjeni. E keni për detyrim të përgjigjeni dhe unë dua
3 që të marr përgjigje të qartë. Nëse nuk e dini, mund të thoni
4 që "Nuk e di." Por, në këtë rast kam përshtypjen që po na e
5 bëni shumë të vështirë që të kuptojmë se anëtar i cili njësit
6 ishit. Ju lutem.

7 DËSHMITARI: Po se anëtar unë kur kam shku atje nalt
8 domethënë nuk e kam ditë që ekziston brigadë. Domethënë nuk e
9 kam ditë që ekziston guerilja BIA se s'më ka interesu. Pak ma
10 vonë i kam kuptu këto sende. I kam pa ushtarët edhe që kaq. Ma
11 vonë tani kanë fillu këtu brigada e këtu Karadaku që e ka
12 formu zonën, guerilja BIA tani e kam kuptue. Unë kam nejt
13 q'aty, në q'atë vend kam ndejt domethënë s'kom -

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] "Më
15 vonë, më vonë" - çfarë është "më vonë?" E kuptoj që në fillim,
16 pra në '98 nuk e dinit po thatë "më vonë" filluat ta kuptonit.
17 Por kur, kur ndodhi kjo më vonë, shkurt?

18 DËSHMITARI: Ka shkurti ose marsi e kam kuptu që ekziston
19 Brigada 153, ekziston njësia, guerilja BIA. Janë largu ata
20 personat e Karadakut, janë shku në tjetër baza. Unë jam mbetë
21 aty.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.
23 Por pyetja ime është kjo: Në shkurt a e kuptuat se ishit
24 anëtar i BIA-s? A e dinit që ishit anëtar i BIA-s, pra që
25 ishit pjesë e një grupi që quhej BIA?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 117

1 DËSHMITARI: Me kuptue edhe me shku me ushtarët e
2 gueriljes BIA jam shku prej datës 17 prill.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
4 lini të paqartë. Unë po ia lë Prokurorit.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Edhe unë jam i paqartë, të
6 nderuar Gjykatës, por mbase mund t'i lexoj dëshmitarit një
7 pjesë të intervistës që z. Mustafa ia ka dhënë ZPS-së dhe
8 dëshiroj që të paraqitet me numrin 069404-TR-ET, Pjesa 3,
9 faqja 20 në ekran ju lutem.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
11 Sekretare, ju lutem vazhdoni.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Zmadhojeni pak ju lutem duke
13 filluar nga rreshti 8 se është shumë e vogël për mua.
14 Py. Këtu po jemi në kontekst të - po flasim pra për këtë bazë
15 të sigurt, shtëpi e sigurt që përdorej nga BIA në Zllash.
16 Prokurori pyet:

17 "Shtëpia e sigurt, a i përkiste dikujt? Domethënë që, në
18 kuptimin që a banohej asokohe?"

19 Z. Mustafa përgjigjej:

20 "Po ishte një fshatar i Zllashit."

21 Pyetje:

22 "A ju kujtohet emri?"

23 Përgjigje:

24 "Nuk e gjej dot emrin. Nuk më kujtohet tani. Ishte një
25 fshatar që jetonte në Zllash. Po për shkak të luftës ishte

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 118

1 larguar nga fshati dhe jetonte në Prishtinë asokohe. Ne i
2 morëm leje atij në Prishtinë. Pra jo thjesht unë po kolegët e
3 mi që të qëndronim aty. Por unë e di edhe dy a tri anëtarë të
4 familjes së tyre ishin anëtarë të UÇK-së. Njërin prej tyre
5 gjithashtu e kisha ushtar, ishte ushtar i imi."

6 Pra këtu z. Mustafa e ka fjalën për ju apo jo?

7 Pë. Po, 100 për qind për mu e ka.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

9 Prokuror, mund ta kishit bërë edhe pyetjen në mënyrë të hapur,
10 jo kështu të drejtpërdrejtë.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e nderuar
12 Gjykatëse.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim]:

14 Py. Në këtë pjesë që unë ju lexova z. Mustafa flet për një
15 grupi që i kishte kërkuar leje pronarit të shtëpisë për ta
16 përdorur kompleksin e shtëpive të familjes. Ju i thatë
17 Mbrojtjes se ishit aty i pranishëm kur Dini kërkoi leje për të
18 përdorur kompleksin e shtëpive të familjes. Po z. Mustafa a
19 ishte i pranishëm?

20 Pë. Jo, nuk e kam pa. Se ky edhe në deklaratë e paska cek që
21 një grup domethënë ka kërku, jo z. Mustafa.

22 Py. Po ai thotë "ne". E përfshin dhe veten e vet te grupi.

23 Pë. Salih Mustafën në realitet unë nuk e kam pa atë ditë aty.
24 Kanë qenë edhe do të tjerë, Agroni nëse s'gaboj. Këtë s'e kam
25 pa. Ndoshta ka qenë edhe mrena.

1 Py. I thatë Mbrojtjes -

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe është me DSM00012.

3 Py. Që Salihu ishte drejtuesi i BIA-s. Ju kujtohet që keni
4 thënë kështu?

5 Pë. Po, mesa e di unë.

6 Py. Dhe kur e kuptuat këtë?

7 Pë. Ndoshta në janar e kom kuptu, ndoshta. Nuk muj me cek
8 data a din. Veç e kam kuptue, më kanë tregu disa djem aty që
9 kanë ndejt. I kam pyt kur o ardhë. Ose në dhjetor ka mujt me
10 konë. I kam pyt kush është ky. Cali. Edhe emrin nuk ia kam
11 ditë deri mbas luftës.

12 Py. Por, ju thatë që ndoshta mund të jetë në shkurt, në mars
13 që keni qenë anëtar i BIA-s. Deri në atë moment duhet ta keni
14 marrë vesh se kush ishte komandanti apo jo? Pra po i thoni
15 Trupit Gjykues që ishit në Zllash, ishit anëtar i BIA-s dhe
16 nuk e dinit se kush ishte komandanti i BIA-s?

17 Pë. Unë të thashë, Cali u ardhë edhe ma herët aty. Ka ardhë u
18 shku, ka ardhë u shku domethënë.

19 Py. Kompleksi jua j siç e lexuam nga deklaratat që ka dhënë z.
20 Mustafa përdorej si shtëpi e sigurt nga BIA, kështu ishte?

21 Pë. Po, u konë pak më e sigurt, jo veç e BIA-s, jo veç BIA që
22 e ka përdorë. E kanë përdorë edhe të tjerë ushtarë aty. U konë
23 më e sigurt se u konë dikund 22 kilometra prej Prishtinës. Ka
24 pasë roje - e spjegova edhe ma herët në deklaratë - në disa
25 fshatra përreth. Edhe u konë e sigurt një kohë.

1 Py. Përdorej si shtëpi e sigurt, si një vend i sigurt ku mund
2 qëndronte BIA. A jeni dakord me këtë?

3 Pë. U përdorë për ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
4 jo veç BIA. E shpjegova, edhe Karadaku, edhe të brigadës kanë
5 ndejt aty.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dëshiroj që të lexoj një pjesë
7 të dëshmisë publike të z. Fatmir Sopi dhënë përpara këtij
8 Trupi Gjykses dhe do të doja t'ju kërkoja që të komentoni, në
9 qoftë se do më lejonte Trupi Gjykses.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
11 lutem, vazhdoni.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Kjo është dëshmia që ka dhënë
13 Z. Sopi më 18 janar 2022, në faqen 2045, rreshti 11. Do të
14 lexoj nga transkripti, të nderuar Gjykses.

15 Py. Z. Sopi, që ju thatë që e njihni i ka thënë këtij Trupi
16 Gjykses në datën që përmenda më sipër.

17 "Njësitë BIA a kishte ndonjë vend, qëndronte në ndonjë
18 vend në Zllash?"

19 Përgjigjja është:

20 "Po, ata kishin një vend në Zllash."

21 "Dhe ku e kishte vendin ku qëndronte njësitë? Ku gjendej
22 kjo pikë?"

23 "Ishte në pikën më të lartë të Zllashit, në verilindje të
24 fshatit."

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të

1 kalojmë tek faqja 2048, znj. Sekretare, tre faqe më poshtë,
2 rreshti 2.

3 Py. "Ju lutem a mund të na e shpjegoni pak vendin ku
4 qëndronte BIA në Zllash?"

5 "Ishte një shtëpi e zakonshme në fshat me një kopsht dhe
6 me ndërtesa ku jetohej. Ishin të njëjtat shtëpi sepse UÇK-ja
7 nuk kishte kazerma."

8 "Kujt i përkiste kjo shtëpi?"

9 "Pronari ishte një fshatar nga i njëjti fshat. Quhej Adem
10 Krasniqi."

11 "Në vitin 1999 ai jetonte në këtë kompleks?"

12 Përgjigje:

13 "Jo, familja ishte larguar për në Prishtinë disa vite më
14 përpara sesa viti 1999."

15 A jeni dakord, a pajtoheni me atë çfarë ka thënë, çfarë
16 është thënë këtu në dëshminë që ka dhënë dëshmitari, z.
17 Krasniqi?

18 Pë. As unë s'jam tu e mohu që guerilja BIA ka qëndru aty.

19 Edhe shpia ka qenë e Adem Krasniqit. Unë e kam pasë axhë. Edhe
20 në vitet '90-të pasi që jeta u bo shumë e vështirë me jetu në
21 fshat, se familjarët, djemtë ikën prej Kosovës, u detyrue edhe
22 ky me ardhë në Prishtinë.

23 Py. E kuptoj. Pra pajtoheni me atë çfarë ka thënë Z. Sopi?

24 Pë. Unë anglisht s'po e marr vesh po sa e kuptova, po q'ashtu
25 është, guerilja BIA ka qëndru aty.

1 Py. Në rregull. Faleminderit. Në fakt edhe ju vetë i keni
2 thënë Mbrojtjes -

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Dhe të nderuar Gjykatës i
4 referohem dokumentit DSM00013.

5 Py. Ju thatë për shembull që disa anëtarë të BIA për ca kohë
6 kanë qëndruar në kompleks. E saktë kjo? A ju kujtohet ta keni
7 thënë këtë gjë?

8 Pë. Ushtarët e gueriljes BIA kanë ardhë, kanë ndejt dy-tri
9 ditë. Janë ndërru, kanë vazhdu nëpër lokacione të tjera. Më
10 kujtohet në dhjetor kur kanë ardhë do ushtarë, atëherë se kom
11 ditë që është guerilja BIA. Mbasandej e kom kuptu. Kanë ndejt
12 dy-tri ditë dhe kanë shku nëse s'gaboje në Majac. Atje u kanë
13 luftë edhe kanë shku në ndihmë atje.

14 Py. Disa ushtarë të BIA-s ndërkohë kanë qëndruar atje apo jo
15 kryesisht?

16 Pë. Po, kanë qëndru, kanë shku kështu. Janë ndërru, qysh me
17 ta spjegju.

18 Py. Ti ke qëndruar aty pjesën më të madhe të kohës apo jo?

19 Pë. Po kam qëndru, jo pjesën ma të madhe, po kom qëndru. Nuk
20 muj me mohu atë që kom qëndru aty. Edhe unë kom udhëtu nëpër
21 Prishtinë e jam kthy.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë të nderuar
23 Gjykatës.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit, znj. Përkthyes do të bëjmë më të mirën e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 123

1 mundur.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

3 Py. A ju kujtohet emri i ndonjë ushtari të BIA-s që ke parë
4 atje në kompleks?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
7 lutem hiqini pak dëgjueset, z. Dëshmitar.

8 E keni fjalën ju z. Von Bone.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbase e kam gabim. Por e dëgjova
10 pyetjen të bëhej në qoftë se ju kujtohet ndonjë emër i
11 ushtarëve të BIA-s në kompleksin e BIA-s. E dëgjova siç duhet
12 apo jo?

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Mënyra sesi është shkruar këtu është që: "A ju kujtohet ndonjë
15 emër?"

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Po thjesht se dua që të jem i
17 sigurt.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
19 çfarë është shkruar këtu është në faqen 11, rreshti 16, është:
20 "A ju kujtohet ndonjë emër i ushtarëve të BIA-s në kompleks?"

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë pyeta në qoftë se "keni
23 parë ushtarë të BIA-s në kompleks." Nuk thashë asgjë tjetër.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Vetëm thjesht dhe nuk
25 e dëgjova mirë dhe doja të isha i sigurt që isha në drejtimin

1 e duhur.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Vazhdoni z. Prokuror.

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

5 Py. Unë po ju pyesja në qoftë se ju kujtohet ndonjë emër i
6 ushtarëve të BIA-s në kompleks. Po e përsëris dhe njëherë
7 pyetjen. A ju kujtohet ndonjë emër i ndonjë ushtari që ka
8 qëndruar në kompleks?

9 Pë. Që ka qëndru tërë kohën?

10 Pë. Jo, jo që e keni parë. Ndoshta nuk është e thënë që të
11 jetë gjithë kohën. E kuptojmë që njerëzit kanë qenë në lëvizje
12 e sipër.

13 Pë. Po, Basri Canolli ka qenë një kohë në guerilja BIA. Tani
14 ka kalu me brigadë sa e kam kuptu unë. Më 17, domethënë, i kam
15 mësu gati shumë emna që na shkum në front me ta. Ka qenë
16 Azemi, Avnija, Muhamet.

17 Py. Ndonjë tjetër?

18 Pë. Ismajl. Ka shumë, mos ia nisim se - deri në mëngjes.

19 Py. E kuptoj.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në qoftë se mund ta freskoj
21 kujtesën e dëshmitarit me disa emra, të nderuar Gjykatës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
23 mundesh, por dua t'ju kujtoj dhe njëherë që të flisni më
24 ngadalë sepse e vë re që nuk kishte përfunduar me përkthimin
25 përkthyesja.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për këtë. Do
2 të mundohem që të mbaj ritmin.

3 Tani le të shohim dokumentin DSM00013.

4 Py. Në këtë dokument, Mbrojtja ju bën këtë pyetje:

5 "Dhe kishte anëtarë të tjera të njësisë BIA?"

6 Dhe ti në përgjigje thua që:

7 "Unë jam takuar me Bimin dhe Bahriun."

8 E konfirmoni ta keni thënë këtë gjë?

9 Pë. Po, i kam taku.

10 Py. Shpendi ishte në fillim me BIA-n pastaj u bë pjesëtar i
11 Brigadës 153. E kujtoni ta keni thënë edhe këtë?

12 Pë. Mesa e di unë që po ka qenë i BIA-s tani ka shku me
13 brigadën. Po nuk u konë qëllimi me kënd po shkon, veç me luftu
14 armikun.

15 Py. Dhe më pas deklaroni se kishte dhe disa ushtarë të rinj
16 që qëndronin atje për një periudhë të shkurtër. Ju kujtohet
17 kjo?

18 Pë. Po.

19 Py. Dhe thoni më tej që edhe Isa Kastrati ka qëndruar aty.
20 Edhe pse sot nuk e dini në qoftë se ai ka qenë pjesëtar i BIA-
21 s apo jo?

22 Pë. Jo, nuk e di as që ka qenë pjesëtar i BIA-s a ça u konë,
23 nuk e di. Veç e di që ka qëndru aty deri sot 23 vjet.

24 Py. Po Dardani? Ka qenë Dardani atje në kompleks?

25 Pë. Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 126

1 Py. Po Muhamet Ajeti?

2 Pë. Muhameti, Muhamet Ajeti ka qenë - në dhjetor o ardhë -
3 q'atë e ceka edhe ma herët. Edhe ka nejt nëse s'gaboju një
4 natë, dy, edhe janë shku për - a janë shku në Majac ku janë
5 shku nuk e di. Edhe deri në ofensivë pastaj nuk e kam pa më.
6 Në realitet e kom pa edhe në Prishtinë atë ditë që e kanë
7 sulmu Prishtinën forcat serbe. Tani deri në ofensivë s'e kom
8 pa.

9 Py. A është shok i juaji ai?

10 Pë. Me Muhametin banojua në të njëjtën lagje. Edhe në shkollë
11 jena konë bashkë. Nëse s'gaboju është një gjeneratë ose dy para
12 meje ose jo, mbas meje.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
14 iu përgjigjët pyetjes.

15 DËSHMITARI: A e ki shok më tha, Muhametin. Iu përgjigjua
16 që jemi në të njëjtën lagje, jena rritë bashkë aty, njihemi.
17 Shok s'e kom se nuk rri shumë me të, nuk kam ndejt shumë me
18 të. Po jena njoftë se jena në të njëjtën lagje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
20 është një përgjigje. Tani e kuptoj më mirë.

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës a mund të
22 më lejoni një çast që të konsultohem me kolegët?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
24 lutem, vazhdoni.

25 [Prokurori i Specializuar këshillohet]

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

2 Py. Ju deklaruat se e keni parë z. Ajeti në tetor. Keni
3 qëndruar një natë ose dy dhe pastaj shkuat diku tjetër. Dhe
4 pastaj nuk e keni parë më deri në fund të ofensivës. Këtë keni
5 thënë apo jo?

6 Pë. Jo, nuk e thashë ashtu. Thashë në dhjetor, jo në tetor.

7 Py. Në rregull. Domethënë erdhi në dhjetor, qëndroi një natë
8 ose dy netë. Edhe pastaj u largua dhe nuk e keni parë më deri
9 në kohën e ofensivës. Kjo është dëshmia juaj?

10 Pë. E kam pa edhe në Prishtinë.

11 Py. Po jo në kompleks?

12 Pë. Jo në kompleks, deri në ofensivë s'e kam pa.

13 Py. Ofensiva - për çfarë date po flet? Po flet për ofensivën
14 e mesit të prillit që ofensiva preku zonën e Gollakut?

15 Pë. Gjithmonë i referohena datës 17.

16 Py. A do të çuditëshit të mësonit se në fakt z. Ajeti ka
17 ardhur në kompleks në mars të vitit 1999 dhe është takuar me
18 ju atje.

19 Pë. Ndoshta edhe o taku, po s'e di. S'më kujtohet që jam taku
20 unë me Muhametin. Jam taku me shumë njerëz. I tregova dhe ma
21 herët Avokatit që unë kam lëvizë domethënë e kam marrë
22 traktorin, kam mbajt njerëz. Ndoshta dhe jam taku, nuk muj me
23 e mohu. Nëse jam taku, jam taku.

24 Py. Po. Sepse duket sikur ka një tendencë të vazhdueshme që
25 kur të thuhet që "a ka ndodhur kjo?", ju pastaj në përgjigje

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 128

1 thoni "që mund të ketë ndodhur" dhe kështu. Dhe më përpara
2 thatë që e keni takuar atë në dhjetor dhe nuk e keni takuar më
3 që prej asaj kohe deri në ofensivë. Ndërkohë që tani më
4 ekziston dhe mundësia që mund ta keni takuar në mars të vitit
5 1999 në kompleks.

6 Cila është përgjigjja? A jeni takuar me z. Ajeti në
7 kompleks përpara ofensivës?

8 Pë. Nuk më kujtohet, ndoshta ka qenë po nuk më kujtohet. Nuk
9 muj as me thonë po as jo.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
11 keni referencë për neve?

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Është
13 në deklaratën që na ka bërë, na e ka dhënë Mbrojtja. Është
14 dokumenti DSM00619.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 rregull. E kisha të fikur mikrofonin. Thashë më përpara që
17 gjatë gjithë kohës duam që të marrim referencat.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër, znj. Gjykatëse.

19 Py. Kur është hera e fundit që ke folur me komshiun tënd, z.
20 Ajeti, z. Krasniqi?

21 Pë. Hera e fundit?

22 Py. Po, hera e fundit.

23 Pë. Kur jena ardhë veç jena përshëndetë kështu me dorë po
24 s'kena bisedu.

25 Py. Do të thuash kur ke ardhë ti këtu [REDAKTUAR]?

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]. Hera e fundit.

4 Py. Po përpara kësaj kohe?

5 Pë. Domethënë tash nuk po muj me u taku me kurrkund se unë
6 prapë jetoj në katund. Në mëngjes shkoj, në mbrëmje vij e nuk
7 muj me u taku me kurrkund.

8 Py. A keni diskutuar që jeni dëshmitar i Mbrojtjes në
9 çështjen kundër Mustafës?

10 Pë. Jo, deri atë ditë që e kam pa [REDAKTUAR] nuk e kam ditë
11 që është.

12 Py. Pra deri në ditën kur e keni takuar në [REDAKTUAR] nuk e
13 kishit idenë që z. Ajeti do të vinte këtu për të dhënë dëshmi,
14 kështu?

15 Pë. Nuk e kom ditë që vjen.

16 Py. Pra ju nuk keni folë me të përpara sesa të
17 intervistoheshit nga Mbrojtja në shkurt të vitit 2022?

18 Pë. Jo, jo.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] 2021, jo 2022.

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, 2022.

21 E di që është pak si herët por do të kërkoja që të bënim
22 një pushim tani në vend që ta bëni pushimin në orën 4.00 sepse
23 më duhet të kontrolloj nga dy-tre gjëra.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Mendoj se mund ta bëjmë këtë. A mund t'i thoni Trupit Gjykses

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 130

1 ju lutem sesa kohë ju nevojitet për të përfunduar me pyetjet e
2 dëshmitarit.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ndoshta gjysmë ore, të nderuar
4 Gjykatës.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Do të bëjmë një pushim tani për 30 minuta deri në orën
8 4:20 dhe do të vazhdojmë pastaj deri në orën 5 e gjysmë. Kjo
9 është ajo çfarë kemi planifikuar tani.

10 Z. Dëshmitar, z. Krasniqi, do të bëjmë një pushim për 30
11 minuta. Faleminderit për momentin. Dhe znj. Sekretare do t'ju
12 shoqërojë të dilni nga salla.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Faleminderit, znj. Sekretare.

16 Seanca ndërpritet për 20 minuta deri në orën 4.20.

17 --- Pauza fillon në orën 15.52

18 --- Seanca rifillon në orën 16.20

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vërej
20 se ekipet kanë të njëjtën përbërje si edhe më parë. E thamë
21 këtë për procesverbalin. Përpara se të vijojmë me dëshmitarin.

22 Z. Prokuror, kam një pyetje të cilën jua drejtoj juve.
23 Pyetja është kjo, a mund t'i thoni Trupit Gjykues se cilat
24 janë apo cilat objekte, struktura, në cilat objekte,
25 struktura, pretendohet se janë mbajtur të ndaluar njerëzit?

1 Pastaj mund të përdorim një fotografi si ajo që kemi
2 përdorur sot.

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] nëse ju kuptoj qartë i kërkon
4 Prokurorisë se cila është ajo që përpiqet, që të nxjerrë
5 Prokuroria në këtë rast?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Në fakt ka aktakuza nuk është
8 se përcakton një ndërtesë në veçanti dhe e kemi dëgjuar
9 dëshminë për shembull të 1679 besoj, i cili e ka bërë të ditur
10 se më përpara kjo është.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] për
12 mua nuk ka problem por do të mjaftonte nëse do të tregonit
13 strukturat e ndryshme. Mund të jepni edhe referenca por - nuk
14 desha që të improvizojmë, le të themi

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për parashtrim përfundimtare që
16 do të bëjmë në fund fare lidhur me provat që kemi ne, atëherë
17 do të jepen edhe këto. Por ajo që themi ne, që pretendojmë
18 pra, që ndërtesa 4A është vendi ku janë mbajtur të ndaluar
19 njerëzit dhe kemi dëshmitarë të cilët kanë treguar rrugën që
20 kanë bërë, që kanë ecur kur i kanë nxjerrë nga ajo ndërtesë
21 dhe pastaj i kanë çuar sipër shkallëve. Dhe besoj se të paktën
22 tre dëshmitarë, siç do ta bëjmë të qartë edhe në parashtrimet
23 tona përfundimtare kanë bërë të ditur se kjo ishte ndërtesa
24 kryesore. Dhe ne po kështu besojmë se ndërtesa ku ndodhet
25 dhoma 4 është përdorur dhe për marrjen në pyetje, mbase edhe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 132

1 për mbajtje të ndaluar për një kohë të shkurtër.

2 Janë këto dy ndërtesa pra, të cilat Prokuroria i ka
3 përshkruar si vend ku është bërë torturë, ndalim, torturë dhe
4 trajtim mizor.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit. Atëherë mund të sillni dëshmitarin të hyjë në
7 sallë. Dhe sot do të vazhdojmë deri në orën 5.30 dhe atëherë
8 do ta mbyllin për sot.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
11 se u kthyet z. Krasniqi.

12 DËSHMITARI: Mirë se ju gjeta.

13 Do të vazhdojmë sot deri në orën 5.30 minuta. Tani do
14 t'ja jap sërish fjalën z. Prokuror.

15 Z. Prokuror, ju lutem

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim]:

17 Py. Nuk më kanë mbetur shumë pyetje. Përpara se të kalojmë
18 tek tema, dy temat e fundit. Dëshiroj që të kthehem shumë
19 shkurt shokut dhe fqinjit Muhamet Ajetit, i njohur edhe
20 ndryshe edhe si Shyti.

21 Na thatë se nuk keni diskutuar të qenit si dëshmitar të
22 Mbrojtjes për çështjen Mustafa. Nuk e keni diskutuar me të.

23 Pë. Jo, jo, jo nuk e kam diskutuar.

24 Pë. Keni qenë anëtarë të të njëjtit njësit, ai tha se ka
25 ardhur në kompleks në mars. Të dy jeni dëshmitarë në këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 133

1 çështje gjyqësore jeni dhe komshi dhe kurrë nuk keni diskutuar
2 për akuzat e ngritura në këtë çështje gjyqësore.

3 Pë. Këtë po them, se ai tash ka dalë, domethënë që dy-tri
4 vjet s'është aty duke banuar në atë lagjë, afër ku i kena pasë
5 shtëpiat dhe unë jam tuj nejt në katund në Zllash. Unë edhe
6 Salih Mustafën ka 15 vjet që nuk e kam parë.

7 Py. Salih Mustafën?

8 Pë. Po, nuk e kam pa.

9 Py. A keni biseduar me z. Ajetin, përpara se t'ia jepnit ju
10 deklaratën Mbrojtjes, në shkurt të vitit 2021?

11 Pë. Jo, s'kam biseduar.

12 Py. Dhe pas arrestimit të Salih Mustafës, a keni diskutuar
13 ndonjë herë me z. Ajeti për faktin se komandanti juaj -- ish-
14 komandanti juaj ishte arrestuar?

15 Pë. Jo, s'kam biseduar për këtë rast.

16 Py. Asnjë fjalë?

17 Pë. Duket ndoshta absurde diçka, po nuk kam biseduar. S'em ka
18 ardh rasti me bisedu me të.

19 Py. Asnjë fjalë, asgjë?

20 Pë. Yes [në anglisht], s'kam bisedu me të.

21 Py. A dini nëse z. Ajeti dhe Salih Mustafa janë apo jo shokë?

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Më falni, e nderuar Gjykatëse.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 dëshmitar mund t'i hiqni dëgjueset.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, përpara se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Selatin Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. De Minicis

Faqe 134

1 të kalojmë në një diskutim shumë të gjatë se ç'është a ç'nuk
2 është shoku, e kemi diskutuar edhe më përpara që përcaktimi i
3 njerëzve mund të ndryshojë. Mund të jetë i ndryshëm. Mbase do
4 të ishte më mirë që ta thoshim ndryshe.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
6 ju dëgjova, ju kuptova. Edhe më përpara i kemi bërë pyetje
7 dëshmitarit për shokët --

8 Prisni mos flisni ndërkohë që flas unë -- dhe ai e bën
9 mirë dallimin midis shokut dhe të njohur.

10 Nëse e shohim që do të bëhet problematike do të ndërhyj
11 dhe do të parafrazojmë por deri tani besoj se koncepti i
12 shoqërisë është një fjalë e pranuar gjerësisht. Nuk do e
13 diskutojmë më.

14 Z. Prokuror, mund të vazhdoni

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim]:

16 Py. A dini - ah po. Mund t'i vendosni.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
18 kërkoi ndjesë duhej t'i kushtoj edhe unë vëmendje kësaj

19 Z. DE MINICIS: [Përkthim]

20 Py. A e dini nëse Muhamet Ajeti dhe Salih Mustafa janë shokë?

21 Pë. Na shokë jemi krejt, deri në vdekje jemi shokë mes vedit.

22 Po sa janë taku dhe si janë taku nuk e di. Nuk muj me thonë që
23 janë takue, as që s'janë takue se nuk i kam pa. Të kallxova,
24 me vite nuk i kam pa.

25 Pë. A i keni parë që të jenë, të kenë qenë bashkë, të jenë

1 shoqëruar, a nuk e di, për shembull me ndonjë përkujtimore të
2 UÇK-së apo në një rast.

3 Pë. Është interesant se unë Facebook s'kam hiç e nuk i
4 përdori rrjetet sociale e nuk i kam pa. Se atje ku jetoj unë
5 interneti s'bën.

6 Py. Në rregull. Ju kujtohet ndonjë herë -- hera e fundit për
7 shembull apo një herë kur ta keni parë z. Mustafa dhe z. Ajeti
8 së bashku, që të kenë qenë së bashku? Ju kujtohet, e keni në
9 mendje një kujtim të tillë? Mund të kenë kaluar muaj, mund të
10 kenë kaluar vjet?

11 Pë. Ndoshta kur më ka vdekur baba, që janë kanë, po ndoshta
12 që ajo a kanë në 2002 që janë ardhë për ngushëllime, ndoshta
